

**Takimi**  
Optimist për emrin, takimet vazhdojnë

Fq.4



**TATIMI I DYFISHTË**  
Fukaraja paguan dy herë!

Fq.6



Botohen vargjet e panjohura të Kadaresë


**82-vjetori i lindjes**

Fq.19



# Koha

www.koha.mk



**E "çmendur" pas futbollit**

Fq.14

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3278 · e hënë 29 janar, 2018

-3°C | +9°C

15 DEN

## AKTUALE

**S'ka dy diploma me ca provimet diferenciale**



Laramania e programeve studimore brenda të njëjtit fakultet, jo çdoherë mundëson pajisjen më dy diploma, pra kualifikimin me dy profesione të ndryshme vetëm duke iu nënshtruar disa provimeve diferenciale. Sipas kompetentëve të Fakultetit Filologjik "Bllazhe Koneski", në Shkup, rikualifikimi nuk nënkupton edhe profesion të ri. Janë gjëra krejt të ndryshme të cilat burojnë nga...

Fq.5

## GLOBI

**Vetëm një referendum i dytë shpëton britanikët**

Fq.17

## RAJON

**Te serbët, çmimi i ujit më i lirë, por askush s'paguan**

Fq.16



## LIGJI PËR GJUHËT SOT SËRISH NË SEANCË

# VMRO S'MBUSHET ME MEND!



Me dhjetë grupe deputetësh dhe me mbi 32 mijë amendamente, VMRO-DPMNE do të tentojë ta bllokojë dhe me këtë - të ndryshojë nenet e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. LSDM akuzon se VMRO është kundër vlerave evropiane dhe kundër konceptit të një shoqërie për të gjithë, ndërsa BDI paralajmëron se e kanë çelësin për të hedhur poshtë amendamentet e partisë së Mickovskit

Fq.3

## Varfëria është ulur këmbëkryq

Shkup, 28 janar - Shumica e qytetarëve në Maqedoni me vështirësi i mbulojnë nevojat e tyre elementare me të ardhurat e pakta mujore. Një e treta e qytetarëve thonë se me shumë vështirësi e kalojnë muajin, 26 për qind thonë se mbijetojnë vështirë, 29.4 për qind thonë se mbijetojnë me vështirësi të caktuara. Vetëm 13 për qind e popullatës thotë se e kalojnë muajin lehtë. Sipas anketës së Entit të Stati-

stikës me titull "Kushtet për të ardhurat dhe të jetesës në Maqedoni në vitin 2016", afër 7 për qind e amvisërive kanë tualet jashtë shtëpive, afër 6 për qind nuk kanë as vaskë apo dush, ndërsa 13.5 për qind jetojnë në kushte joadekuate të jetesës (çati që pikon, mure të lagështa ose xhama të thyer). Nga ana tjetër, 46 për qind e popullatës nuk posedojnë kompjuter, ndërsa 37 për qind nuk posedojnë...

Fq.6



## EDITORIAL

AMORALITETI  
I NJË ALEANCE

Emin AZEMI

A është e mundur që gazetarët e njëjtë në Kosovë, të cilët fillimisht mbështetnin iniciativën për themelimin e Gjykatës Speciale, tani e mbrojnë të kundërtën e asaj që e kishin thënë, duke u munduar ta bindin publikun se shfuqizimi i Ligjit për këtë gjykatë tani është i arsyeshëm. Ky është një problem që nuk i përket vetëm realitetit kosovar, kur gazetarët i përshtaten diskursit të politikanëve dhe brenda një harku të shkurtër kohor pikëpamjet e tyre lëvizin nga njëri ekstrem te tjetri. Por shfaqja kaq e hapur e këtij disbalanci në mes të interesit publik dhe llogarive të vogla të politikanëve, ka një kosto të riparueshme për shëndetin etik e profesional të audiencës. Gjithmonë në qendër të një debati ndodhet një kauzë dhe ajo mbrohet apo atakohet nga përfaqësues të ndryshëm, varësisht nga këndi i dioptrisë politike e konjunkturale. Në Kosovë, fillimisht kundër Gjykatës Speciale ishte vetëm Lëvizja Vetëvendosje dhe mediat, gati pa përjashtim, u rreshtuan në një sulm frontal kundër kësaj force politike. Tani kur rrethanat kanë ndryshuar, të njëjtat media janë rreshtuar në anën e atyre politikanëve të cilëve aktualisht po iu pengon Gjykata Speciale. Është ky një moral i ulët profesional i një gazetarie që me vetëdëshirë po bëhet repart i zgjatur propagandistik i politikës, duke e shndërruar hapësirën publike tela me gjemba para hundëve të diplomatëve Perëndimorë.

Humbja e integritetit etik e profesional të mediave dhe gazetarëve po ndodhë në një kohë kur Kosovës i nevojitet më tepër se kurdoherë një masë kritike që do të ishte jo vetëm korigjuese e politikës por edhe një valvule ndihmëse që do të vinte në qarkullim ide e pikëpamje alternative. Futja pa kriter e gazetarëve e opinionistëve të ndryshëm në strukturat shtetërore, në vend se të rregullonte imazhin e politikanëve në sytë e publikut, ka ndodhur e kundërta. Gazetarët e rikomponuar në aparatçik shtetërorë, janë bërë "zagarë" kujdestarë të politikanëve që ua sjellin para këmbëve trofeun e ngordhur të publikbërjes. Punën e zakonshme të zyrtarëve që kishin përpiluar komunikata të thjeshta, tani po e bëjnë alamet emra të gazetarisë, të cilët mediat po i lexojnë me syza të tjera.

Politika ka nevojë për kompetentë nga brenda për ta menaxhuar, dhe për media nga jashtë për ta kritikuar. Nëse kompetentët mbesin jashtë politikës, ashtu siç po ndodhë aktualisht, kurse gazetarët futen në politikë, atëherë diçka nuk është në rregull. Është diçka që nuk funksionon. Përfshirja e përfaqësuesve të medias nëpër parti politike do të ishte normale sikur me kohë ta kishim rregulluar raportin mes fjalës së lirë dhe veprimtimit politik. Do të ishte normale sikur partitë politike të ndienin nevojë nga brenda për mungesë kuadrosh që dinë të kritikojnë apo të formojnë opinion publik. Nëse kritikën e huazon nga media dhe e kompensojnë si mall i munguar në parti politike, atëherë shtrohet një pyetje fundamentale: Si t'iu besojmë kritikuesve të ardhshëm që vijnë nga fusha e media? Kur politika shpreh mendime publike përmes gazetarëve "të pavarur", siç po ndodhë aktualisht në Kosovë, me rastin e fushatës kundër Gjykatës Speciale, s'do mend se viktimitë e parë e këtij konfuziteti publik bien vetë ndjekësit e kësaj politike, por edhe një audiencë më e gjerë e cila e ka të vështirë ta dallojë kufirin se ku mbaron politika e keqe dhe ku fillon gazetaria e pamoralshme. Amoraliteti i kësaj aleance si produkt final ka armiqësimin e Kosovës me Perëndimin dhe për pasojë - degradimin e gjithë asaj që është arritur me mund e gjak.

## NDALENI QYMYRIN

"Rreth 5 mijë punëtoresh të KEK-ut për çdo vit marrin falas një kamion qymyr. Ky kamion ka diku 12-13 ton qymyr, dhe shitet për 250 euro. Po ashtu, edhe mijëra tonelata tjera të qymyrit u shiten direkt atyre që nuk janë punëtor të KEK-ut, dhe një sasi e madhe nxirret nëpër miniera private të qymyrit - atëherë del se në treg gjate sezonës së dimrit shiten dhe digjen me dhjetëra e mijëra tonelata qymyr.

Sot në Prishtinë, dhe fshatrat përreth, pothuajse nuk ka shtëpi që nuk ka te instaluar ngrohjen qendrore. Dhe të gjitha këto shtëpi për shkak të kostonë së ulët, po përdorin qymyrin për ngrohje. Një të afërme që e pyeta një ditë se sa shpenzon qymyr në kaldajen e tij të ngrohjes qendrore, më tha se mesatarisht 'një thes qymyr për çdo dy orë'. Tash llogariteni se sa qymyri është duke u djegur çdo 24 orë në Prishtinë dhe rrethinë.

Shto këtu edhe veturat, këta janë dy faktorët kryesor që po e shkaktojnë ndotjen katastrofale në Prishtinë, dhe jo oxhaqet e KEK-ut nga Obiliqi. Agjensionet Për Mbrojtje të Mjedisit, bashkë me institucionet tjera qeveritare, sa na tregojnë a duhet me i hap a jo dritaret, duhet të ofrojnë zgjidhje për këtë katastrofë ekologjike! Së pari, urgjentisht duhet ndaluar përdorimin e qymyrit për ngrohje. Sigurisht, duke gjetur alternativa te reja...

Psh, investime urgjente në shtrirjen e kogjenerimit në secilën lagje të Prishtinës, Fushë-Kosovës, Obiliqit dhe fshatrave përreth!", shkruan në profilin e tij në FB, gazetari Ilir Mirena.



## ABSURDITETI I AMENDAMENTEVE

"Absurditeti i 30.000 amendamenteve nuk është për ligjin për gjuhën, sepse atë e kishin pranuar dhe s'kishin vërejtje, por për 'shpëtimin' e tyre", shkruan në profilin e tij në Facebook, deputeti i BDI-së, Artan Grubi, duke ironizuar me mbi 30 amendamentet e VMRO-së kundër Ligjit të gjuhëve.

## BATO STANISHIQI DHE FAHRI TESHKABUDALLA

"Nga dita e sotme më nuk do ta vajtoj largimin e tyre nga Lëvizja. Përfundimisht ata më nuk e meritojnë vëmendjen tonë as emrin e shenjtëruar të ëndrrës shqiptare Vetëvendosje!

Le të bëjnë parti të re me sponsorin e tyre medial Bato Stanishiqin dhe me Fahri Teshkabudallën...", shkruan në Facebook, publicisti Salih Kabashi.

## LIDERI ME MJEKËR OSE ME SYZE

"35.000 amendamente nga VMRO-DPMNE kundër Ligjit të Gjuhës Shqipe!"

VMRO mund ta reformojë pamjen e liderit me mjekër ose me syze, por përderisa nuk reformon mendësinë politike, sidomos në raport me shqiptarët, asnjëherë nuk mund të udhëheqin një Maqedoni multietnike.

PS Deklarata e përbashkët dhe tryeza shqiptare doemos të funksionojë, do apo jo lideri i BDI-së", shkruan në profilin e tij në Facebook, anëtar i Kryesisë Qendrore në Aleancën për Shqiptarë, Flakron Bexheti.

## MEDIACitate

Gjendja e sigurisë në veri të Kosovës është e qëndrueshme dhe qytetarët nuk kanë arsye të kenë frikë. Kështu të paktën ka thënë shefi operativ i Policisë së Kosovës për Veriun, Zeljko Bojiq.

Ai ka thënë për "Radio Kontakt Plus" se gjendja e sigurisë në komunat e Mitrovicës së Veriut është e qetë Bojiq ka rikujtuar se ditëve të fundit nëpër këto zona nuk është shënuar asnjë incident serioz.

Megjithatë Ministria e Jashtme e Gjermanisë gjatë ditës së djeshme paralajmëroi qytetarët e saj se duhet të shmangin lëvizjet në veri, pasi situata është e tensionuar.

"Situata në veri të Kosovës mbetet e tensionuar", thuhet në një deklaratë të kësaj ministrie. E duke aluduar në këto deklarime, ministri serb i mbrojtjes, Aleksandar Vulin kërcënoi duke thënë se ushtria serbe po monitoron situatën në veri të Kosovës.

Madje, ai theksoi se shërbimet serbe i kanë vërtetuar pretendimet e shtetit gjerman. Ndaj Vulinit, reagoi Enver Hoxhaj, i cili tha se deklaratat e tij janë kërcënim për Kosovën.

(Gazeta Metro, 28 janar)

Kryeministri grek, Aleksis Cipras, i ka informuar drejtuesit politikë në Athinë mbi bisedimet që ka zhvilluar këto ditë me Shqipërinë e Maqedoninë. Duke iu referuar bisedimeve me Shqipërinë, ai ka thënë se rruga tashmë është hapur për normalizimin e plotë dhe përmirësimin e marrëdhënieve mes dy vendeve.

"Ne jemi të gatshëm për një marrëveshje strategjike me Shqipërinë, e cila do zgjidhë dallimet thelbësore dhe do çojë drejt nxitjes së negociatave të Shqipërisë për pranimin e saj në Bashkimin Evropian". Cipras ka shtuar se "një konsensus i gjerë politik duket se po krijohet për këtë çështje, të cilën unë e mirëpres". "Për fqinjshin Shqipërinë informova liderët politikë se është hapur rruga për zgjidhjen e divergjencave dhe normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes dy vendeve. Sipas tij, lidershpi i ri politik maqedonas ka vullnet për të negociuar për një zgjidhje të reciproke të pranueshme për çështjen e emrit, një çështje që ka përcaktuar marrëdhëniet mes dy vendeve në 25 vitet e fundit.


(TV Klan, 28 janar)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## CILA ËSHTË DITËLINDJA E VËRTETË E ISMAIL QEMALIT

Ismail Qemali, në fakt quhej Ismail bej Vlora. Emri i tij u ndryshua gjatë kohës së regjimit komunist mbi botëkuptime komuniste ndaj titullit "Bej", por asnjëherë asnjë historian dhe personalitet nuk e ka shpjeguar këtë ndryshim. Ismail Qemali ishte një nga personazhet më të rëndësishme të familjes së njohur Vlora, një familje e pasur dhe me shumë tradita, dhe që ka nxjerrë shumë personazhe të rëndësishëm në jetën politike shqiptare.

Ismail Qemali lindi më 16 tetor 1846 në Kaninë të Vlorës dhe vdiq më 24 janar të vitit 1919 në Peruxha të Italisë. Vetëm pas vitit 1990 është mësuar nga historiani turk me orgjinë shqiptare, Nexhip Alpan, që ditëlindja e Ismail Qemalit ishte në një ditë me atë të Enver Hoxhës. Në tekstet e historisë së Shqipërisë dhe tekstet mësimore datëlindja është shkruar më 24 janar 1844. Në fakt ajo është më 16 tetor 1844.



## LIGJI PËR GJUHËT SOT SËRISH NË SEANCË, VMRO ME MBI 32 MIJË AMENDAMENTE

Me dhjetë grupe deputetësh dhe me mbi 32 mijë amendamente, VMRO-DPMNE do të tentojë ta bllokojë dhe me këtë - të ndryshojë nenet e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. LSDM akuzon se VMRO është kundër vlerave evropiane dhe kundër konceptit të një shoqërie për të gjithë, ndërsa BDI paralajmëron se e kanë çelësin për të hedhur poshtë amendamentet e partisë së Mickovskit



# VMRO S'MBUSHET ME MEND!

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 28 janar - Parlamenti i Maqedonisë sot në ora 11 duhet ta fillojë seancën e 32-të, ku në rend të ditës është Ligji për përdorimin e gjuhëve, në lexim të tretë, me të cilin avancohet përdorimi i gjuhës shqipe, e i cili është kthyer nga ana e presidentit të shtetit Gjorge Ivanov pa dekret të nënshkruar dhe me vërejtje të shumta. Seancën për këtë ligj, kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi e caktoi në afatin e paraparë dhe e vendosi në votim të seri-shëm, ndërsa për Ligjin janë parashtruar edhe mbi 32.000 amendamente rekord nga ana e VMRO-DPMNE-së opozitare. Kaq amendamente deri tani nuk janë parashtruar për asnjë ligj në Parlament. Amendamentet janë parashtruar gradualisht të premtën dhe shtunën nga ana e deputetëve të VMRO-DPMNE-së, ndërsa pas përfundimit të afatit të shtunën në ora

16:30, nga shërbimet e Parlamentit informuan se kanë marrë mbi 32.000, ndërsa nga partia opozitare VMRO potencuan se bëhet fjalë për mbi 30.000. Përmbajtja e amendamenteve, sipas Rregullores së Parlamentit, duhet të jetë në pajtim me vërejtjet e presidentit Ivanov. Partitë nga shumica në pushtet - LSDM dhe BDI, ashtu sikurse Lëvizja BESA dhe Aleanca për Shqipëtarët nuk parashtruan amendamente për ligjin. LSDM-ja përmes kumtesës reagoi, duke potencuar se qartë është se VMRO-DPMNE-ja nuk ka kapacitet t'i braktis politikën e destruktimit dhe të bllokadave, të cilat shkaktojnë tensione politike, ndarje dhe përçarje në shoqëri.

"VMRO-DPMNE-ja deri tani ka pasur mundësi të merr pjesë në

procesin e miratimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, por në vend të kësaj, partia opozitare me zgjedhje të saj, zgjodhi të mos merr pjesë në procesin reformues", njoftuan nga LSDM-ja. Lajmërimi se VMRO-DPMNE do të kthehet në Parlament vetëm për të bllokuar një ligj, akuzon LSDM, është edhe një dëshmi se partia opozitare vazhdon të punon kundër interesave të qytetarëve dhe shtetit, qëllimi i vetëm i saj është të krijojë bllokadë politike të re me të cilën do bllokohet procesi reformativ.

"Me sjelljen e tillë, VMRO-DPMNE është kundër vlerave evropiane dhe kundër konceptit të një shoqërie për të gjithë, edhe njëherë e vërtetoi se nuk merakoset për interesat dhe nevojat e qytetarëve, por luan

lojëra të ulëta dhe të lexueshme politike. Ligji për përdorimin e gjuhëve është në përputhshmëri me Kushtetutën dhe Amendamentin e 5-të dhe i njëjti nuk favorizon dhe nuk diskriminon asnjë gjuhë, por e avancohet përdorimin e gjuhëve të të gjithë komuniteteve jo-shumicë që jetojnë në Maqedoni, ndërsa përdorimi i gjuhës maqedone dhe shkrimi i saj cirilik edhe më tutje mbeten gjuhë dhe shkrim i vetëm zyrtar në territorin e Republikës së Maqedonisë, në marrëdhëniet ndërkombëtare, mbrojtje, politikën monetare dhe policinë qendrore. Çdo hap drejtë ndërtimit të një shoqërie për të gjithë, koncept në të cilin LSDM beson fuqishëm dhe i cili ka marrë mbështetje nga qytetarët në ciklet e fundit zgjedhore, është

në interes të Republikës së Maqedonisë dhe qytetarëve të saj", thuhet në reagimin e LSDM-së

Ndryshe, amendamentet e parashtruara do të shqyrtohen vetëm në seancë plenare. Propozuesit e amendamenteve kanë të drejtë në tre minuta ta elaborojnë secilin amendament veçmas, ashtu që sipas llogarive të caktuara, për këtë do të nevojiten 145 ditë. Koordinatorët kanë të drejtë edhe në vërejtje procedurale nga tre minuta. Që të miratohet amendamenti, nevojitet të votojnë 61 deputetë. Deputeti i VMRO-DPMNE-së, Vllatko Gjorçev, i cili i koordinon deputetët e kësaj partie në Parlament, paralajmëroi se ata do të paraqiten "si edhe deri tani", respektivisht me dhjetë grupe të deputetëve.

## DELEGACIONI QEVERITAR E VIZITOI FAMILJEN ZYLBEARI

# Dalin rezultatet e para të tragjedisë në Tetovë

"Kur do të përfundojnë ekspertizat atëherë do t'i konfirmojmë edhe arsyet. Sipas informacioneve të para, është e mundur që zjarri të kishte shpërthyer nga defekti dhe vjetërsimi i instalimit ose nga ndonjë aparat i ngrohjes", theksoi ministri Spasovski



Tetovë, 28 janar - Delegacioni qeveritar të shtunën e vizitoi shtëpinë e djegur të familjes Zylbeari në Tetovë dhe shprehu ngushëllime për tragjedinë në të cilën jetën e humbën nëna Fatimja me katër fëmijët e saj minoren. Në delegacionin qeveritar ishin ministri i Punëve të Brendshme Oliver Spasovski, ministri i Punëve të Jashtme dhe Politikës Sociale Mila Carovska dhe zëvendëskryeministri përgjegjës për zbatimin e

Marrëveshjes së Ohrit dhe sistem politik Hazbi Lika, ndërsa ishin të mbështetur nga kryetarja e komunës së Tetovës Teuta Arifi me bashkëpunëtorët e saj. Ministri Spasovski, tha se vizita është që t'ju japin

ngushëllime në emër të kryetarit Zaev dhe në emër të anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. "Kjo është një tragjedi e madhe që ka ndodhur në Tetovë e cila na ka tronditur të gjithëve,

tragjedia është më e madhe për familje, për qytetarët e Tetovës dhe për Republikën e Maqedonisë. Kjo duhet të jetë një mësim për të gjithë ne që bashku të përfshihemi në përmirësimin e kushteve për jetë

në Maqedoni me qëllim që të pamundësohen tragjeditë e tilla në të ardhmen. Sot e dorëzuam ndihmën e cila është simbolike nga ana e Qeverisë, sollëm vendim për ndihmë të familjes në vlerë prej 300.000 denarëve dhe me ndihmën që e dhuroi kryetarja e Komunës, Teuta Arifi që t'i shërbejë familjes dhe të mund të vazhdojnë me jetën", deklaroi ministri Spasovski. Në lidhje me atë nëse dihen arsyet për zjarren, Spasovski u përgjigj se inspektimi nga ana e SPB Tetovë ka përfunduar ndërsa procedura për ekspertizë është në vijim. "Kur do të përfundojnë ekspertizat atëherë do t'i konfirmojmë edhe arsyet. Sipas informacioneve të para, është e mundur që zjarri të kishte shpërthyer nga defekti dhe vjetërsimi i instalimit ose nga ndonjë aparat i ngrohjes", theksoi ministri Spasovski. (U.H)

TAKIMI I LIDERËVE PËR KONSENSUS KOMBËTAR PËR KONTESTIN ME GREQINË

"Me zgjidhjen e kontestit bilateral për emrin që zgjat 25 vjet, synojmë të kemi përparim për integrimin e vendit në BE, që është e rëndësishme për interesat nacionale të vendit", tha Zaev

# OPTIMIST PËR EMRIN, TAKIMET VAZHDOJNË

Shkup, 28 janar - Takimi i kreut shtetëror dhe politik të vendit për propozimet e ndërmjetësuesit të KB-së Methju Nimit për zgjidhjen e kontestit me emrin informativ dhe konstruktiv, ishte vlerësimi i të gjithë pjesëmarrësve në takimin në Klubin e deputetëve, i cili zgjati më shumë se pesë orë. Asnjë nga pjesëmarrësit nuk dëshiron të elaboronte detajet e propozimit të Nimit, nëse ky propozim ishte i pranueshëm dhe nëse kishte pajtueshmëri midis subjekteve politike. Ata njoftuan takime të tjera të tilla për koordinimin e pozicioneve për zgjidhjen e kontestit me emrin. Kryeministri Zoran Zaev ka deklaruar pas takimit me liderët se ky proces kërkon përkushtim, përfshirje dhe përgjegjësi politike me qëllim ndërtimin e konsensusit nacional. "Me zgjidhjen e kontestit bilateral për emrin që zgjat 25 vjet, synojmë të kemi përparim për integrimin e vendit në BE, që është e rëndësishme për interesat nacionale të vendit", tha Zaev. Ai tha se marrëveshja mund të arrihet nëse ekziston vullnet politik dhe kurajo nga ana jonë por edhe zgjidhja është e mundur nëse ky vullnet politik ekziston edhe në palën greke. "Integrimi së bashku me reformat dhe masat ekonomike janë kryeso-



re për një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e RM-së", shtoi kryeministri. Pas përfundimit të takimit, kreu i BDI-së Ali Ahmeti tha para gazetarëve se ky është fillimi i fundit i një procesi shumë të rëndësishëm. Sipas Ahmetit Maqedonia e ka vendin në BE dhe në NATO e kjo duhet të ndodhë sa më parë. "Është shumë e rëndësishme që vendi ynë të jetë pjesë e NATO-s dhe e Bashkimit Evropian, të ketë paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm", deklaroi Ahmeti. Mbledhja u mbajt me iniciativë të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në mbledhje, morën pjesë

kryeministri Zoran Zaev, ministri i Punëve të Jashtme Nikolla Dimitrov, ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska. Të pranishëm ishin edhe kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti i cili ishte i shoqëruar nga Hazbi Lika dhe Bujar Osmani, zëvendëskryeministër për Çështje Evropiane. Kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristian Mickovski në takim ishte i shoqëruar nga Aleskandar Nikolovski dhe Vllado Misajllovski. Presidenti Ivanov theksoi se në takim Zaev dhe Dimitrov i njoftuan ata për përmbajtjen e bisedimeve që kishin me homologët e tyre grekë,

por edhe për idetë e Nimit që janë ekspozuar në prag të ardhjes së tij në Shkup. "Pres që në të ardhmen Qeveria të na informojë dhe të koordinohemi për të gjitha aktivitetet", tha Ivanov, duke shtuar se Qeveria ka përgjegjësi që dhe në kohë të informojë opinionin. Ai nuk donte të zbulonte detaje për idetë të Nimit, duke thënë se kështu u dakorduan në takim. Lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickovski, theksoi se takimi ishte i karakterit informativ dhe që nga ky moment e tutje procesi i përgjithshëm për zhvillimin e ne-



GJORGJE IVANOV

Pres që në të ardhmen Qeveria të na informojë dhe të koordinohemi për të gjitha aktivitetet. Qeveria ka përgjegjësi që dhe në kohë të informojë opinionin

gociatave është në duart e Qeverisë dhe se ai pret të informohet në kohën e duhur për gjithçka që do të ndodhë në këtë drejtim. "VMRO-DPMNE mbetet unike në qëndrimin se Republika e Maqedonisë duhet të jetë pjesë e NATO-s dhe BE-së dhe VMRO-DPMNE mbetet në mbrojtjen e interesave shtetërore dhe kombëtare të Republikës së Maqedonisë", tha Mickovski, i cili shtoi se procesi i negociatave duhet të ecë përpara. Sipas tij, ky lloj koordinimi duhet të kishte ndodhur më herët dhe shtoi se ai nuk dëshiron të komentojë propozimet e Nimit, sepse procesi ende është në zhvillim e sipër.

ALI AHMETI PËR "KATIMERININ"

## Zgjidhja për emrin sipas modelit me Bullgarinë

"Mënyra më e mirë për mbylljen e kësaj çështjeje është modeli i Marrëveshjes për fqinjësi të mirë mes Shkupit dhe Athinës, përmes konsensusit mes dy qeverive, e pastaj ratifikimi në dy Parlamentet", thotë Ahmeti në intervistë për gazetën greke "Katimerini"

Athinë, 28 janar - Sipas modelit të Marrëveshjes për fqinjësi të mirë me Bullgarinë, me konsensus mes dy qeverive, e pastaj ratifikimin në

dy kuvendet, të mbyllet çështja për emrin, propozon kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti në intervistë për gazetën greke "Katimerini". Ai thotë se kohë më të mirë për marrëveshje se tani nuk ka dhe sqaron se qeveria do të negociojë që të arrijë marrëveshje, e jo vetëm te negociojë. Me titull "Zgjidhje tani, pa referendum", edicioni javor i gazetës greke "Katimerini", njofton korrespondenti i MIA-s nga Athina, i transmeton qëndrimet e liderit të BDI-së lidhur me negociatat për emrin mes dy vendeve.

"Mënyra më e mirë për mbylljen e kësaj çështjeje është modeli i Marrëveshjes për fqinjësi të mirë mes Shkupit dhe Athinës, përmes konsensusit mes dy qeverive, e pastaj ratifikimi në dy Parlamentet", thotë Ahmeti në intervistë, duke sqaruar se qeveria dhe opozita kanë përgjegjësi historike

të arrijnë marrëveshje dhe t'i dërgojnë qytetarët dhe vendin në NATO dhe BE. "Do të marrim pjesë në negociata që të arrijmë zgjidhje, e jo vetëm që të negociojmë. Na nevojitet zgjidhje, edhe neve në Shkup edhe juve në Athinë. E kohë më të mirë se tani nuk ka", tha Ahmeti. Lidhur me propozimet dhe idetë e Nimit, ai thotë se qeveria së bashku me opozitën i shqyrton dhe tenton të ketë qasje pozitive dhe konstruktive. Lideri i BDI-së, sqaron se termi "Maqedoni" ka qenë pjesë e propozimeve edhe në vitin 2008 në Bukuresht, por edhe në vitin 2011, në kuadër të propozimit "Republika Maqedonia Veriore".

"Termi Maqedoni në emrin e vendit tonë nuk paraqet kërcënim për integritetin territorial dhe sovranitetin e Greqisë", thotë Ahmeti për gazetën "Katimerini" dhe u porosit grekëve që të jenë të sigurt se

vendi i ynë nuk ka pretendim territorial ose diçka të ngjashme për vendin e tyre, dhe se është absurde të supozohet një gjë e tillë. Ahmeti paralajmëron se moszgjidhja e problemit mund t'i ringjallë qëndrimet e vjetra për kufinj të rinj në Ballkan.

"Nëse ky kontest nuk zgjidhet, punët mund të jenë shumë të këqija. Kur punët shkojnë keq për ne, kjo gjithsesi se do të ketë pasoja edhe për Athinën dhe me këtë mund të ringjallen ambiciet e vjetra të qarqeve të ndryshme me qëndrime arkaike për ndarje, për kufinj të rinj në Ballkan. Vlerësoj se kjo është shumë e rrezikshme për të gjithë ne në tërësi", sqaron lideri i BDI-së. Lidhur me atë nëse dhe sa është i mundur konsensus në Maqedoni për çështjen me emrin, Ahmeti dërgon kritika deri te presidenti, Gjorge Ivanov. "Zotëri Ivanov lëshoi mundësi të shkëlqyer



që ta përmirësojë autoritetin e tij të shqiptarët, duke lënë edhe shenjë të tij në përfundimin e pjesës rregullative të Marrëveshjes së Ohrit. Unë pres të mos ketë qasje të njëjtë edhe për çështjen aq serioze për emrin", tha kryetari i BDI-së Ali Ahmeti në intervistën për edicionin javor të gazetës greke "Katimerini".

RIKUALIFIKIMI NUK NËNKUPTON KUALIFIKIM PËR PROFESION TË RI

# S'KA DY DIPLOMA ME CA PROVIMET IFERENCIALE

Valbona Toska, shefe e Katedrës së gjuhës dhe letërsisë shqipe në Shkup, thotë se dilemat e rikualifikimit dhe kualifikimit të ri diskutohen në nivel të fakultetit, universitetit dhe më gjerë. Përkthyesit konsiderojnë se janë të pabarabartë me kolegët e tyre pedagogë. Këta të fundit vetëm me një vulë nga gjykata mund të punojnë edhe përkthyes, ndërsa ne duhet të regjistrojmë fakultetin nga e para dhe të japim 12 provime, shprehet Sebahate Nuhiu



Koha

Laura PAPANIKU

Shkup, 28 janar - Laramania e programeve studimore brenda të njëjtit fakultet, jo çdoherë mundëson pajisjen me dy diploma, pra kualifikimin me dy profesione të ndryshme vetëm duke iu nënshtruar disa provimeve diferenciale. Sipas kompetentëve të Fakultetit Filologjik "Bllazhe Koneski", në Shkup, rikualifikimi nuk nënkupton edhe profesion të ri. Janë gjëra krejt të ndryshme të cilat burojnë nga programet e ndryshme studimore dhe silabuset e lëndëve përkatëse. Kjo është çështja që, sipas tyre, duhet ta kuptojnë të diplomuarit në programin e përkthyesve e të cilët synojnë që me pesë-gjashtë provime diferenciale të vijin deri te diploma e pedagogëve, pra që të kenë mundësi të punësohen edhe si mësimdhënës të gjuhës dhe letërsisë përkatëse.

Një grup të diplomuarish në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Shkup, në programin përkthyes nga gjuha shqipe në maqedonisht dhe anasjelltas, konsiderojnë se janë të pabarabartë me kolegët e tyre të programit pedagog i gjuhës dhe letërsisë shqipe. Sipas tyre, këta të fundit, vetëm me një "vulë nga gjykata", përveçse mund të punojnë si mësimdhënës nëpër shkollë, pa pasur nevojë të japin provime diferenciale, mund të punojnë edhe si përkthyes. Por, që ta fitojnë edhe ata të drejtën e mësimdhënies - është tepër e vështirë, pohon Sebahate Jahiu. "Duhet të kryhet edhe një gjysmë fakultet. Gjatë katër viteve kemi studiuar si gjuhën shqipe ashtu edhe gjuhën maqedonase. Është vërtetë e pakuptimtë që të detyrohemi japim nga 12 provime edhe atë që regjistrohemi edhe njëherë, nga e para në fakultetin ku kemi studiuar", vëren Nuhiu. Sipas saj, problemi qëndron se shumë provime që janë marrë në programin e përkthyesve nuk u njihen si ekuivalente në

programin e pedagogëve. "Jemi në situatë kur fakulteti nuk i njeh provimet e veta", shprehet ajo. Për të alarmuar këtë problem, javën e kaluar grupi i përkthyesve iu drejtua Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës (MASH) por u kthyen që atje pa marrë asnjë e përgjigje për dilemat. "As në MASH nuk u gjend dikush të na japë sqarime për këtë situatë. Na sugjeruan që problemin ta zgjidhim me kuadër të fakultetit", sqaron më tej Nuhiu. Sakaq, e kontaktuar nga KOHA, shefja e Katedrës së gjuhës dhe letërsisë shqipe, Valbona Toska, thotë se dilema të këtilla nuk janë problem vetëm për këtë Katedër. "Janë çështja të cilat diskutohen në nivel të fakultetit dhe universitetit, mbase edhe më gjerë. Kur një kandidat i nënshtrohet rikualifikimit brenda të njëjtit profesion - ata mund të japin provime diferenciale. Por kur kemi të bëjmë me dy profesione, si në rastin konkret me përkthyes dhe pedagogë të gjuhës dhe letërsisë, gjërat ndryshojnë. Duhet që kandidatët të bëjnë regjistrimin në programin e ri studimor dhe pas kësaj, ti nënshtrohen procesit të njohjes së provimeve nga programi i parë studimor", pohon Toska. Meqë bëhet fjalë për programe të ndryshme studimore, pra për kualifikime të reja, sipas saj, është e kuptueshme që të ketë shumë

më tepër se 5-6 provime diferenciale. "Problemi me përkthyesit nga fakulteti jonë (e, jo vetëm), është se ata duan të vijin te diploma e dytë duke dhënë vetëm disa provime diferenciale, pra vetëm të lëndëve që nuk i kanë kaluar si përkthyes. Kjo nuk është e mundur", shprehet ajo. Sepse, edhe të disa lëndë të tjera, që ata i kanë marrë si përkthyes kanë dallime në silabuset e lëndëve, pra në qasjen, fondin e orëve dhe shkallën e thellimit të studimeve të asaj lënde. "Për shembull, ndryshe punohet sintaksa me grupin e përkthyesve dhe ndryshe me grupin e pedagogëve", sqaron Toska, e cila është edhe ligjëruese e lëndës së Sintaksës dhe disa gramatikave në katedrën e shqipes në Shkup. Përveç kësaj, janë disa lëndë si dialektologjia, didaktikat, metodikat, psikologjia, pedagogjia, teoria e letërsisë dhe të tjera, të cilat përkthyesit nuk i kanë pasur fare në programin e tyre të studimeve. Të gjitha këto lëndë, thotë se duhet të jepen që kandidati të mund të vjen deri te një kualifikim i ri. Çështja e vulës së përkthyesve, të cilën mund ta marrin pedagogët e gjuhës dhe letërsisë, është diçka tjetër. Vetë shkalla e kualifikimit tregon për këtë, pra bëhet fjalë për vulë të cilën e jep gjykata dhe jo për diplomë që merret në universitet.

## THIRRJE ARSIMTARËVE TË DORËZOJNË PROPOZIME PËR PROGRAMET ARSIMORE

Ministria e Arsimit dhe Shkencës u bëri thirrje arsimtarëve, si dhe personave kompetent dhe të interesuar, që aktivisht të kyçen në procesin e ndërtimit të modelit të ri për arsimin fillor dhe të dorëzojnë kritikën e tyre, komentet dhe propozimet për përmirësimin e programit mësimor. "Që të krijojmë model arsimor më të mirë dhe më cilësor, duam të dëgjojmë zërin dhe mendimin e personave të cilët çdo ditë janë të kyçur në procesin arsimor -

mësuesit. Në këtë drejtim do të krijojmë model të ri për arsimin fillor dhe plan programe të reja për nxënësit e klasave 1, 2, dhe 3", kumtojnë nga MASH. Grupi i punës i cili do të krijojë modelin e ri arsimor, përbëhet prej ekspertëve të fushës, profesorëve të Fakultetit Filologjik dhe Institutit Pedagogjik, por edhe praktikantët të fushës, gjegjësisht mësuesit të cilët punojnë me nxënësit e klasave 1, 2 dhe 3.

## KRONIKË

### Therren me thikë dy persona para një kazinoje në Prilep

Personi Z.P (54) nga Prilepi u arrestua pasi me thikë i ka therr personat K.R (25) dhe M.R (26). Policia ka arrestuar sulmuesin. Ngjarja ka ndodhur para një kazinoje në Prilep. Z.P. i ka therr personat, njërin në pjesën e shpinës, kurse tjetrin në stomak. Të lënduarit janë dërguar në Qendrën mjekësore në Prilep.

### Plaçkitet një market në rrugën "Skupi"

Dy persona tani për tani të panjohur dhe të armatosur me pushkë mbrëmë kanë plaçkitur një market në rrugën "Skupi" në Shkup. Siç kumtoi MPB-ja, ngjarja është paraqitur nga e punësuar në market rreth orës 21:00. Plaçkitësit kanë hyrë në market derisa ajo dhe kolegja e saj ishin në njërën prej arkave, i kanë marrë paratë nga qarkullimi ditor dhe kanë ikur. Po ndërmerren masa për gjetjen e autorëve.

### Me plagë nga armë zjarri pranohet me Spitalin e Velesit

Të shtunën mbrëmë një person nga Velesi është sjellur i plagosur në spitalin e qytetit. "I lënduari Z.B (42) nga fshati Vizbeg ka pasur lëndime në nëngjurin e djathtë, nga armë zjarri, pistoletë. Si rast urgjent ai është dorëzuar në Klinikën 'Nënë Tereza' në Shkup", njofton policia. Nga policia njoftojnë se po ndërmerren masa për zbardhjen e rastit.

### Një vajzë sulmohet nga qentë endacak në Parkun e Qytetit

Një vajzë e moshës 20 vjeçare nga Shkupi është sulmuar nga qentë endacak në Parkun e Qytetit. Siç informon MPB-ja, dje në orën 11:30, B.N. (20) ka paraqitur se derisa ka lëvizur në Parkun e Qytetit është sulmuar nga 5-6 qen endacak, nga të cilët njëri e ka kafshuar në këmbën e majtë.

### Hetohet zjarri në Lisiçe të Re

Në një zjarr që të shtunën mbrëmë shpërtheu në lagjen e Shkupit, Lisiçe e Re, tërësisht është djegur një shtëpi dhe një pjesë e shtëpisë fqinje. Nuk ka persona të lënduar. Ministria e Punëve të Brendshme kumtoi se tërësisht është djegur një shtëpi dykatëshe e B.XH. (59), si dhe çatia e një pjesë të inventarit në përdhësën e shtëpisë fqinje, pronësi e S.A. (46). Zjarri është shuar tërësisht në orën 00:10 minuta nga ana e Brigadës për mbrojtje kundër-zjarreve të Qytetit të Shkupit e cila ka intervenuar me shtatë automjete dhe 21 zjarrfikës. Merren masa për konfirmimin e arsyeve të cilat sollën deri në shpërthimin e zjarrit. Zjarri shpërtheu mbrëmë rreth orës 22:00 në rrugën "Mihaië Glinka" në lagjen e Lisiçes së Re.

Një e treta e qytetarëve thonë se me shumë vështirësi e kalojnë muajin, 26 për qind thonë se mbijetojnë vështirë, 29.4 për qind thonë se mbijetojnë me vështirësi të caktuara. Vetëm afër 13 për qind e popullatës thotë se e kalojnë muajin lehtë

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 28 janar - Shumica e qytetarëve në Maqedoni me vështirësi i mbulojnë nevojat e tyre elementare me të ardhurat e pakta mujore. Një e treta e qytetarëve thonë se me shumë vështirësi e kalojnë muajin, 26 për qind thonë se mbijetojnë vështirë, 29.4 për qind thonë se mbijetojnë me vështirësi të caktuara. Vetëm 13 për qind e popullatës thotë se e kalojnë muajin lehtë.

Sipas anketës së Entit të Statistikës me titull "Kushtet për të ardhurat dhe të jetesës në Maqedoni në vitin 2016", afër 7 për qind e amvisërive kanë tualet jashtë shtëpive, afër 6 për qind nuk kanë as vaskë apo dush, ndërsa 13.5 për qind jetojnë në kushte joadekuate të jetesës (çati që pikon, mure të

## CILËSIA E JETESËS NË MAQEDONI



# VARFËRIA

# ËSHTË

# ULUR

# KËMBËKRYQ

lagështa ose xhama të thyer). Nga ana tjetër, 46 për qind e popullatës nuk posedojnë kompjuter, ndërsa 37 për qind nuk posedojnë as veturë.

Statistika tregon se 37 për qind e popullatës nuk kanë shkuar në kontroll mjekësor apo mjekim për shkak të mungesës së parave,

ndërsa afër 60 për qind janë përgjigjur se nuk kanë shkuar në dentist, për shkak se nuk kanë mundësi ti lejojnë vetes diçka të tillë.

Anketa e statistikës tregon se 21.9 për qind e popullatës apo mbi 450 mijë qytetarë në vend janë të varfër. Të varfër janë edhe 9 për

qind e të punësuarve, 7 për qind e pensionistëve dhe 41 për qind e të papunëve. Sipas statistikës, pragu i varfërisë ka prekur qytetarët me të ardhurat 6.880 denarë për amvisëritë me një person, ndërsa për familjet me katër anëtarë janë 14.488 denarë.

Analizat më tej tregojnë se

varfëria është më e madhe tek burrat se gratë, ndërsa të ardhura më të vogla kanë personat në fshatra. Amvisëritë në fshatra realizojnë 170 mijë denarë pagë në vit, ndërsa në qytet realizojnë 233 mijë denarë.

Të ardhurat nga pensionet në fshatra janë 57.721 denarë, ndërsa

## PAQARTËSI RRETH TATIMIT TË DYFISHTË

# FUKARAJA PAGUAN DY HERË!

Ekspertët ekonomik vlerësojnë se nëse personat fizik regjistrohen si obligues të TVSH-së që brenda vitit realizojnë të hyra plotësuese mbi 1 milion denarë, atëherë qeveria po i detyron qytetarët të paguajnë më shumë tatime që të mbush buxhetin dhe se me miratimin e këtij ligji do të goditen punëtorët që me të vërtetë punojnë, ndërsa të pasurit do të përkëdhelen duke i liruar nga tatimi



Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 28 janar - Ligji i ri i Qeverisë së Maqedonisë që detyron të gjithë personat fizik të paguajnë TVSH nëse brenda vitit realizojnë të hyra plotësuese më të larta se 1 milion denarë, jo vetëm që ka shumë paqartësi se cilat persona fizik duhet të regjistrohen si tatim pagues, por

ka shkaktuar reagime edhe te njohës të mirë të çështjeve ekonomike. Ata e kritikojnë Qeverinë se me këtë ligj po detyron qytetarët të paguajnë tatime të dyfishta shtetit. Obligimi që personat fizik të regjistrohen si obligues të TVSH-së, sipas ekspertit ekonomik Pavle Gacov, i detyron qytetarët të paguajnë më shumë tatime që të mbush

buxhetin dhe se me miratimin e këtij ligji qëllim iu merren më shumë para punëtorëve që me të vërtetë punojnë ndërsa të pasurit aspak të mos të tatimohen.

"Ky ligj është në funksion që nga viti 2015, por nuk parasheh saktë se cilët persona me të hyrat plotësuese mbi 1 milion denarë duhet të tatimohen. Qeveria këtë

detyrim ligjor do të ishte mirë ta realizonte përmes tatimit progresiv dhe të vlente për personat e pasur gjegjësisht personat fizik që marrin rroga të larta dhe jo personat fizik që marrin rroga minimale dhe realizojnë të hyra plotësuese jashtë rrogës minimale", thotë Gacov. Të ngarkosh personat që fitojnë si ekspertë, drejtorët falimentues, personat që japin hapësira me qira, personat që fitojnë me kontrata autoriale, kontrata në vepër, persona anëtar nëpër bordet mbikëqyrëse dhe qytetarë që ushtrojnë veprimtari bujqësore, eksperti Gacov thotë se i ngjan proverbit popullor se fukaraja dy herë paguan. Ai shpreh i bindur se Qeveria e Maqedonisë nuk do të miraton këtë ligj i cili është në kundërshtim me programin qeveritar se të gjitha masat e reja që do të merren do të jenë në drejtim të përmirësimit të standardeve të jetesës të qytetarëve e jo siç po vepron tani për momentin ku të gjitha vendimet që merr lidhur me tatimet po varfëron edhe më shumë xhepin e qytetarëve. Edhe profesori universitar, Birçe Davitkovski është i mendimit se bëhet fjalë për tatim klasik të dyfishtë dhe se aspak nuk behët fjalë për tatim të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike. "Si duket është bërë

në qytet janë 87.660 denarë . Gjithashtu të dhënat e raportit tregojnë se 30 për qind e popullatës në Maqedoni në vitin 2016 ka qenë seriozisht e privuar materialisht, që nënkupton pamundësinë e realizimit të së paku katër nga nëntë nevojat themelore siç janë: pagesa e qirasë apo komunaleve, ngrohja adekuate e banesës, pagesa e harxhimeve të paplanifikuara, mish në tryezën e ngrënies, peshq apo mish pule në çdo të dytën ditë, pushim një javor, automobili personal, makinë larjeje, televizor me ngjyrë apo telefon. Studiuesit thonë se varfëria është një koncept tepër kompleks dhe i vështirë për t'u matur. Andaj në 30 vitet e fundit studiohet një koncept i ri, i cili kryesisht matet në tregues ekonomikë. Bëhet fjalë për përrjashtimin social që nuk nënkupton vetëm nevojat e natyrës ekonomike, por edhe sociale, kulturore e politike. Përrjashtimi social si burim kryesor ka më shumë probleme (papunësia, mungesa e kualifikimeve profesionale, të ardhurat e ulëta, mjediset e papërshtatshme për të jetuar, problemet shëndetësore, etj.). Maqedonia është shteti i tretë më i varfër në Evropë, sipas EUROSTAT-it, dhe më të varfër se Maqedonia janë vetëm Shqipëria dhe Bosnje e Hercegovina.

Të ardhurat për frymë nga Prodhimi i Brendshëm Bruto në Maqedoni janë sa 36 për qind e mesatares së Bashkimit Evropian, ndërsa konsumi aktual për frymë vlerësohet në 40 për qind e mesatares së BE-së.

praktikë që në Maqedoni, cila do parti të vijë në pushtet, punën e parë që e bëjnë është të prekin xhepin e qytetarëve që realizojnë të hyra plotësuese nga honorarët apo të drejtave autoriale, për të cilat paguajnë tatim personal, dhe tani për të njëjtën punë të realizuar duhet të paguajnë edhe TVSH, në rast se këto të hyra tejkalojnë vlerën prej mbi 1 milion denarë. Është koha që shteti njëherë e përgjithmonë ta kupton se nuk mund me tatimet plotësuese ta mbush buxhetin", thotë Borçe Davitkovski profesor universitar. Nga Drejtoria për të Hyra Publike informojnë se aspak nuk bëhet fjalë për ligj të ri, sepse ky ligj është në fuqi nga viti 2015 dhe se deri më tani si obligues tatimor të TVSH-së, që realizojnë të hyra plotësuese mbi 1 milion denarë, janë të regjistruar mbi 1000 subjekte dhe se ky ligj aspak nuk ka të bëjë me ligjin për honorar, të cilin qeveria e mëparshme donte ta zbatonte. Sipas DHP-së se cilët persona detyrohen të regjistrohen si tatimobligues për pagesë të TVSH-së, nëse brenda një viti realizojnë të hyra plotësuese mbi 1 milion denarë do ta njoftojnë opinionin në konferencën përshtyp që do ta organizojë DHP-ja javën e ardhshme.

RADIO SHKUPI, 73 VJET EKZISTENCË

# RADIO SHKUPI MES SFIDAVE DHE HISTORISË



Pavarësisht sfidave, Radio Shkupi në lumin e gjerë të mediumet radiofonike mban primatin e shtrirjes në gjithë territorin e Maqedonisë. Pashmangshmërisht vazhdon të mbahet ende fortë në dy shtyllat kryesore të saj: muzikën e mirëfilltë dhe programacionin e larmishëm. Kryeredaktori Haki Mustafa, thotë se "gjatë gjithë viteve të funksionimit Radio Shkupi ka arritur të përmbushë misionin e vet si zëri i nevojës së popullatës". Këtu, kanë parakaluar një numër i madh intelektualësh të cilët e zhvilluan dhe e ngritën këtë medium

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 28 janar - Të shtunën janë bërë plot 73 vjet që kur në nderin e radios kumboi fjala shqipe. E parë nga kjo distancë kohore, Radio Shkupi - Programi në gjuhën shqipe përbën padyshim një gur të çmuar në gjerdanin e vlerave të trashëgimisë sonë kulturore. Për dekada me radhë, Radio Shkupi nuk ishte thjeshtë vetëm një medium. Ishite shkollë që duhej të kujdesej për emancipimin dhe edukimin e mesave; ishte një dritare prej ku duhej të shihej në horizont bota e qytetëruar; ishte transmetues i mendimeve progresiste; ishte vendi ku mbidheshmin intelektualët dhe prej ku bëhej shumë më tepër se sa të transmetohej muzikë dhe lajme të ditës. Sot, kur bota ka ecur përpara me teknologjinë informative, duket sikur radios në përgjithësi i është zbehur pushteti. Pavarësisht sfidave, Radio Shkupi në lumin e gjerë të mediumet radiofonike mban primatin e shtrirjes në gjithë territorin e Maqedonisë. Pashmangshmërisht vazhdon të mbahet ende fortë në dy shtyllat kryesore të saj: muzikën e mirëfilltë dhe programacionin e larmishëm.

Digjitalizimi i nisur para disa viteve ka hapur shpresa për perspektiva të reja, ndërsa mundësia për emetimin 24 orë të programeve në gjuhën shqipe sigurisht se do ta kthejnë Radio Shkupin në formën e saj më të mirë për të nxjerrë në pah profesionalizmin

dhe, për ti detyruar institucionet kompetente të jenë në nivelin e përgjegjësive. Me këtë synim, Radio Shkupi kërkon të ec përpara si dhe të pretendojë mediumin e përgjegjshëm përndikimin dhe rolin në që ka në shoqëri, pa harruar edhe peshën e historisë së thujse shtatë dekada e gjysmë. Për momentin në kuadër të programeve të Radio Shkupit emetohet 17 orë program në gjuhën shqipe, 5 orë në gjuhën turke dhe nga 30 minuta program në gjuhën rome, vllahe, bosnjake dhe serbe. Kryeredaktori Haki Mustafa, thotë se "gjatë gjithë viteve të funksionimit Radio Shkupi ka arritur të përmbushë misionin e vet si zëri i nevojës së popullatës shqiptare në Maqedoni". Këtu, plotëson më tej ai, kanë parakaluar një numër i madh intelektualësh të cilët e zhvilluan dhe e ngritën këtë medium. Ndoshta gjatë një periudhe Radio Shkupi ishte zëri i vetëm medial në gjuhën shqipe që depërtonte në çdo cep të Maqedonisë, si dhe jashtë saj. Mustafa, tregon se "më 28 janar të 1945 ishte zëri i Vllado Malevskit që u dëgjua në etër me frazën e njohur Ju flet Radio Shkupi". Deri më 4 maj 1948, funksiononte me ndërprerje në emetim, derisa u angazhuan Paraskieva Maleska dhe Nermine Keti, të cilat për çdo ditë e begatonin programin. Në vitin 1952 për herë të parë filloj të emetohet emisioni për fëmijë, kurse një dekadë më vonë edhe emisioni që u kushtohej femrave. Në vitet e '60 programi në

gjuhën shqipe kishte edhe redaktorin e parë, Talat Avçen, kurse në vitin 1967 u emërua edhe kryeredaktori i parë Murteza Peza. Kështu, Programi në gjuhën shqipe fitoi një fizionomi të re ku emisioni informativ ishte i veçantë. Në ndërkohë u formuan edhe redaksi të tjera si ajo e kulturës, arsimit, ekonomisë, nisi transmetimi i emisioneve për fshatin dhe emetimi i radio-dramave. Gjatë dekadave në vijim në postin e kryeredaktorit erdhën Muamer Vishko, Rrahim Ganiu, Rufki Kiki, Ferid Fejzullahu, Anton Sereqi, Mahi Nesimi, Haki Mustafa, Besnik Mehmeti dhe Reshat Kamberi. Në vitet e '80 në radio Shkup punohej në përpilimin e skemës së re ku do të dilnin në pah shprehjet e shumëllojshme të gazetarisë. Filluan emisionet kontakteve, emisionet informative ditore dhe ato javore. Në këtë periudhë gjithashtu u ndërmarrën disa hapa për pasurimin e fonotekës ku incizoheshin shumë aktivitetet të shoqërive kulturore-artistike të asaj kohe si dhe huazim i emisioneve muzikore nga radio-televizioni i atëhershëm i Prishtinës. Gjatë komunizmit, Radio Shkupi, si dhe shumë institucione të tjera shqiptare përjetuan fazën më të rëndë, atë të diferencimit. Iu ndërrua deri emri, Radio Skopje duke iu referuar toponimit në maqedonisht. Me ardhjen e pluralist, u ndje edhe këtu fryma e ndryshimeve, me të mirat dhe të këqijat që solli sistemi.



**Më 28 janar të 1945 ishte zëri i Vllado Malevskit që u dëgjua në etër me frazën e njohur Ju flet Radio Shkupi". Deri më 4 maj 1948, funksiononte me ndërprerje në emetim, derisa u angazhuan Paraskieva Maleska dhe Nermine Keti, të cilat për çdo ditë e begatonin programin**

## Vetura del nga rruga, katër të lënduar

Shkup, 28 janar - I.R. (22) nga Shkupi, të dielën rreth orës nëntë, duke drejtuar automjet "Ford Eksport" në autostradën Shkup - Tetovë, e ka humbur kontrollin dhe u përplas me një shkëmb. Siç kumtoi policia, au-

tomjeti është rrokullisur, ndërsa I.R. dhe tre bashkudhëtarët të moshës 22, 24 dhe 27 vjeçarë janë lënduar dhe dërguar në spitalin e Tetovës. Është kryer ekspertizë dhe po ndërmerren masa për ndriçimin e rastit.

## Goditet me gurë treni që qarkullonte nga Shkupi për në Kërçovë

Shkup, 28 janar - Disa persona të panjohur dje, rreth orës 17:00 e kanë goditur me gurë trenin e udhëtarëve numër 660 i cili ka lëvizur nga Shkupi drejt Kërçovës, kum-

toi policia. Rasti është paraqitur dy orë më vonë, rreth orës 19:00. Nuk ka të lënduar, është thyer xhami i një dritare të trenit. Merren masa për gjetjen e autorëve.

Derisa shteti tri herë deri tani jep mundësi për legalizim, në terren ende evidentohen ndërtime pa leje. Te objektet për banim individual dhe familjar, sipas institucioneve kompetente, ende nuk ka zbatim të tërësishëm të Ligjit për ndërtim. Të dhënat e fundit nga Enti Shtetëror për Statistikë tregojnë se në vitin 2016 në territorin e Maqedonisë janë regjistruar 1037 objekte të ndërtuara në mënyrë joligjore

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 27 janar - Pronarët e ndërtimeve pa leje morën edhe një mundësi të tretë nga shteti për fitimin e statusit juridik. Pas fillimit të këtij procesi disavjeçar, në mars të vitit 2011, pothuajse shtatë vite më vonë janë legalizuar dhe është dhënë listë pronësore për 195.092 objekte, përafërsisht 50 për qind nga gjithsej 440.000 ndërtime pa leje për të cilat është parashtruar kërkesë të statusit juridik. Në fillim të procesit të legalizimit të objekteve të ndërtuara në mënyrë joligjore nga marsi deri në shtator të vitit 2011 janë parashtruar mbi 360.000 kërkesa. Në afatin shtesë, megjithatë, që u mundësua në fillim të vitit 2016 janë parashtruar edhe 80.000 kërkesa. Me ndryshimet e fundit të ligjit për trajtim të objekteve të ndërtuara në mënyrë joligjore nga dhjetori i vitit të kaluar, u mundësua afat shtesë për parashtrimin e kërkesave për legalizim, nga janari deri në dhjetor të këtij viti, ndërsa deri nga fundi i qershorit të këtij viti për ata të cilët paprakisht kanë kërkuar legalizim, por nuk e kanë kompletuar dokumentacionin me elaborat, llogari ose deklaratë nga noteri.

Një muaj jo të plotë pas zbatimit të afateve të reja, Ministria dikasteriale dhe komunat dërguan apel deri te qytetarët që t'i respektojnë afatet, me kohë të parashtrorjone dokumentacion dhe të mos presin deri në ditën e fundit. Premtuan edhe angazhim për shmanjen e pengesave në kuadër të kompetencave të veta për përsheptimin e procesit dhe paralajmëruan riekupim të kuadrove komunale që të përmbushin të gjitha kërkesat. Në elaborimin e vendimit të Qeverisë së re për afatet shtesë, Ministria e Transportit njoftoi se analiza dhe kontaktet e drejtpërdrejta në terren treguan se në Maqedoni deri tani janë legalizuar 50 për qind nga ndërtimet pa leje. Në shumicën e rasteve për shkak të procedurës së madhe dhe të komplikuar administrative, qytetarët nuk kanë arritur në afatin e parashikuar ta realizojnë të drejtën për legalizim. Afatet shtesë me ligjin e

## QEVERIA VAZHDON AFATIN, JANË LEGALIZUAR VETËM GJYSMA



# EDHE NJË SHANS PËR NDËRTIMET PA LEJE

ri janë vlerësuar si posaçërisht të rëndësishme për ata që gjatë periudhës së kaluar për shkaqe të ndryshme nuk e kanë kompletuar dokumentacionin. Për të gjitha lëndët e tilla, komunat kanë marrë obligim që në afatin sa më të shkurtër të mundur t'i njoftojnë palët e involvuara se kërkesat e tyre paraprake janë jovalide, që të mund ta shfrytëzojnë afatin e ri prej gjashtë muajve të parashtrorjone të reja me dokumentacion të plotë.

Të dhënat nga komunat tregojnë se janë të shpeshta rastet kur, edhe pse është parashtruar kërkesë për legalizim, nuk është dorëzuar elaborat gjeodezik, respektivisht as që është kërkuar t'u përgatitet ose megjithatë ai të porositet, por të mos është ngritur nga ndërmarrjet gjeodezike që e përpunojnë. Përvojat e administratës komunale tregojnë se procesin e legalizimit jo rrallë e frenojnë edhe e pengojnë edhe punët e pazgjidhura pronësore-juridike, procedurat pronësore, mungesat e pëlqimit nga fqinjët, gjë që nxit konteste gjyqësore dhe zvarritjen e tërë procedurës.

### NË SHKUP JANË LEGALIZUAR 63.366 OBJEKTE

Në sektorin për Kadastër në Shkup deri tani janë evidentuar 63.366 objekte të legalizuara. Në komunat e Shkupit rekorder sipas

**Në Sektorin për Kadastër në Shkup deri tani janë evidentuar 63.366 objekte të legalizuara. Në komunat e Shkupit rekorder sipas numrit të kërkesave të parashtruar nga fillimi i procesit është Komuna e Gazi Babës, ku është kërkuar status juridik për 18.800 ndërtime pa leje**

numrit të kërkesave të parashtruar nga fillimi i procesit është Komuna e Gazi Babës, ku është kërkuar status juridik për 18.800 ndërtime pa leje. Për shkak të elaboratit jo të dorëzuar gjeodezik, administrata në atë komunë ka refuzuar 4.284 lëndë ose 23 për qind nga numri i përgjithshëm. Pozitivisht janë zgjidhur rreth 40 për qind, respektivisht 7.650 lëndë. Për 3.146 lëndë, megjithatë ende nuk është bërë mbikëqyrje për konfirmimin e situatës faktike në vendin e ngjarjes. Në Strumicë, megjithatë nga deri tani gjithsej 12.500 kërkesa të parashtruar për legalizim të objekteve të ndërtuara në mënyrë joligjore deri në vitin 2011, janë zgjidhur pothuaj 4.500. Nga sektori për urbanizëm pranë Komunës së Stru-

micës njoftojnë se ky intensitet i ngadalësuar i zgjidhjes së lëndëve ka të bëjë edhe me fuqinë në rënie pagesore të qytetarëve. Siç thonë, kanë dhënë pajtueshmëri urbanistike dhe llogari, por me muaj dhe vite qytetarët nuk vinë t'i paguajnë dhe t'i marrin. Krahas Gazi Babës në Shkup më së shumti kërkesa për legalizim janë parashtruar në Kisella Vodë, Gjoçe Petrov, Aerodrom dhe Çair. Ndërsa nga qytetet tjera në Kumanovë, Prilep dhe Shtip.

Në drejtim të përmirësimit të kushteve për legalizim për kategoritë e rrezikuara sociale të qytetarëve, shteti i liri nga harxhimet për elaborate gjeodezike shfrytëzuesit e ndihmës sociale dhe financiare. Deri tani janë parashtruar 8.282 kërkesa për përpunim falas të elaboratit gjeodezik për legalizim, prej të cilave 1.896 janë për Shkupin. Siç parashikoi edhe me zgjidhjen e parë ligjore për këtë dedikim, kusht për legalizim të objektit është që ai të ndërtohet përfundimisht më 3 mars të vitit 2011. Kërkesat parashtrohen deri te komunat, ku dorëzohet kopje e letërnjoftimit, faturë e rrymës dhe ujit ose deklaratë e noterit se objekti është ndërtuar para miratimit të ligjit, pas çka procedura parashikon edhe dorëzimin e elaboratit gjeodezik. Tërë procesi rrumbullak-

sohet me marrjen e listës pronësore, me të cilin mund të tregtojnë ose ta vendosë si garanci në bankë për marrjen e kredisë.

### NDËRTIME TË REJA PA LEJE NË TERREN


Derisa shteti tri herë deri tani jep mundësi për legalizim, në terren ende evidentohen ndërtime pa leje. Te objektet për banim individual dhe familjar, sipas institucioneve kompetente, ende nuk ka zbatim të tërësishëm të Ligjit për ndërtim. Të dhënat e fundit nga Enti Shtetëror për Statistikë tregojnë se në vitin 2016 në territorin e Maqedonisë janë regjistruar 1.037 objekte të ndërtuara në mënyrë joligjore. Në mënyrë joligjore janë ndërtuar 203 objekte për banim, si dhe 174 rindërtime, mbindërtime dhe adaptime, 168 rrethoja, 111 objekte afariste, 107 garazhe, 107 objekte ndihmëse, 10 terasa verore... Pjesa më e madhe e ndërtimeve pa leje janë në Shkup, 40, pas çka vijojnë Kumanova me 20, Liko-va dhe Tetova me nga 15, Strumica 14, Struga tetë, Shtipi katër... Tjetër është situata te objektet e kategorisë së parë, të cilat janë me rëndësi për shtetin. Në periudhën për vitin vijues dhe vitin e kaluar në regjistrin për udhëheqjen e procedurave inspektuese pranë Inspektoratit kompetent shtetëror për ndërtimtarë dhe urbanizëm nuk janë evidentuar ndërtime joligjore. Kontrollat e rregulla inspektuese që kryen inspektorati shtetëror për ndërtimtarë dhe urbanizëm tregojnë se të gjithë pjesëmarrësit në ndërtimin e ndërtimeve të kategorisë së parë i kanë respektuar obligimet ligjore. Procesi i legalizimit në shtet, sipas parashikimeve me Ligjin, duhet të përfundojë deri në vitin 2021.

## TRUP KOORDINUES PËR RREGULLIMIN E TË DREJTAVE TË PUNËS

Sindikata e pavarur e transportuesve me kamionë (MAKAMTRANS) dhe Sindikata e pavarur e punonjësve të ndërtimit, inxhinierëve dhe tregtarëve në ndërtimtarë (SPPNITN) kërkuar të formohet Trupi koordinues ku punonjësit do të mund t'i paraqesin shkeljet eventuale të të drejtave të punëtorëve. Kryetari i Sindikatës së pavarur të transportuesve me kamionë (MAKAMTRANS) Strasho Jovanov deklaroi se qëllimi për formimin e një trupi të tillë është që të

nxiten punëtorët për t'i paraqitur shkeljet e të drejtave të punëtorëve. Trupi koordinues do të funksiononte në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, ndërsa në të, siç theksoi Jovanov, do të anëtarësoheshin zëvendësministri i Punës, drejtori i Inspektoratit të punës, kryetari i Këshillit ekonomik-social, kryetari i MAKAMTRANS, kryetari i SPPNITN, ekspert nga sfera e marrëdhënieve të punës dhe kryetari i konfederatës së biznesit.






## I jepet lamtumira e fundit Sali Ramadanit

Kërçovë, 28 janar - Është varrosur dje ish-deputeti i Parlamentit të Maqedonisë, Sali Ramadani Kërçova. Pas një sëmundje të shkurtër, të shtunën, Ramadani ndërroi jetë në qytetin e tij të lindjes. I lindur në vitin 1939 në Kërçovë, Sali Ramadani ishte një protagonist i politikës në Maqedoni në periudhën nga mesi i viteve të 90-ta si deputet i PPD-së dhe më vonë i PDSH-së në Parlamentin e Maqedonisë. Më 8 korrik të 1997 nga foltorja e Parlamentit të Maqedonisë nxori flamurin kombëtar dhe e shpalo-si pranë sallës së Parlamentit. Kjo ngjarje tensionuese ndodhi vetëm një ditë para ngjarjeve të Gostivarit të 9 korrikut të vitit të njëjtë. "Të dashur deputetë, mos u frikësoni sepse ky është flamuri i Skënderbeut dhe nuk kafshon! Do të vijë dita që ky flamur do të jetë zyrtarë, do të vijë dita që në këtë parlament do të flitet shqip...", kishte thënë Ramadani në foltoreshën e Parlamentit.



## BANORËT NË AKSION EKOLOGJIK



# NË DOBROSHT AKSION PËR PASTRIMIN E RRUJËVE

Organizatori i këtij aksioni është Demir Sejdiu, një mërgimtar i cili tashmë ka marrë përkrahjen edhe të strukturave tjera të këtij fshati. "Këtë aksion e ndërmora pasi që i takoj këtij fshati, ndërsa me ndihmën e forumit rinor, pastaj edhe Bashkësisë Lokale - filluam këtë aksion dhe kam shpresë se kjo nismë do të vazhdojë edhe më tutje"

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 28 janar - Në fshatin Dobrosht të Komunës së Tearcës, me iniciativë të disa banorëve është ndërmarrë një aksion për pastrimin e rrugëve të fshatit. Jo vetëm kaq, por gjatë këtij aksioni janë duke u pastruar edhe rrugët në pjesët e poshtme të fshatit për në tokat bujqësore. Organizatori i këtij aksioni është Demir Sejdiu, një mërgimtar i cili tashmë ka marrë përkrahjen edhe të strukturave tjera të këtij fshati. "Këtë aksion e ndërmora pasi që i takoj këtij fshati, ndërsa me ndihmën e fo-

rumit rinor, pastaj edhe Bashkësisë Lokale - filluam këtë aksion dhe kam shpresë se kjo nismë do të vazhdojë edhe më tutje. Para dy jave filluam me pastrimin e rrugës kryesore, pastaj vazhduam edhe në rrugët tjera në fshat, ndërsa tashmë vijojmë edhe në pjesë tjera ku ka më shumë nevojë", tha Sejdiu. Përkrahje për këtë nismë për pastrimin e fshatit nga mbeturinat organizatori ka marrë edhe nga ana e Xhamisë së fshatit. "Padyshim se kur bëhet fjalë për kontributin e shoqërisë, sidomos për pastrim - nuk duhet të hezitohet askush, pra asnjë banorë i këtij vendbanimi. Ne si hoxhallarë i kemi përkrah gjithmonë dhe do të përkrahim edhe në të ardhmen, sepse edhe ana fetare na udhëzon për pastërti. Kjo nuk do të thotë pastërti vetëm në trup, por edhe të kemi pastërti edhe në shtëpi, në rrugë edhe gjithkund", tha Amdiarif Xhemi, imam i fshatit Dobrosht. Mbështetje kësaj nisme i dhanë edhe Bashkësia Lokale bashkë me forumin rinor të fshatit Dobrosht. Fitim Osmani nga Forumi Rinor i fshatit Dobrosht thotë se ky aksion është një organizim mes shumë strukturave të fshatit që ka për qëllim pastrimin e rrugëve nga mbeturinat. "Pastrimi i ambientit duhet të jetë prioritet për



të gjithë dhe ne i dhamë mbështetje Demir Sejdiut si iniciator i këtij aksioni ekologjik. Kjo iniciativë përfshin lagjet më të frekuentuara të fshatit dhe aktualisht ky aksion është duke vijuar shumë mirë dhe presim që të kemi një ambient më të pastër në fshatin tonë", tha Fitim Osmani nga Forumi Rinor i fshatit Dobrosht. Nga Bashkësia Lokale thonë se kjo iniciativë është mbështetur nga ata dhe është një iniciativë vullnetare. "Ky organizim është në mënyrë vullnetare të gjithë së bashku për një Dobrosht të pastër. Këtë e ka organizator bashkëfshatari ynë që është në mërgim Demir Sejdiu, dhe ne i kemi dhënë mbështetje. Besoj se kjo iniciativë shumë fisnike nuk duhet të ndalet deri këtu, por duhet të vazh-

dojë edhe më tej. Kjo ka rrjedhë që dy javë, dhe kohë pas kohë kemi patur organizime ditore dhe kemi filluar në fshat dhe më pas kemi pastruar edhe lumenjtë nga mbeturinat", tha Xhevat Dauti, përfaqësues i Bashkësisë Lokale të fshatit Dobrosht. Pastrimi i rrugëve në këtë fshat ka filluar ditë më parë dhe është duke vijuar, ndërsa qëllimi është që fshati të jetë më i pastër. Përndryshe, fshati Dobrosht ndodhet përgjatë rrugës Tetovë-Jazhincë ku pjesa dërmuese e banorëve të këtij fshati janë mërgimtarë, ndërsa aksionet e këtylla janë të shpeshta sidomos janë të njohura manifestimet kulturore gjatë verës në këtë fshat që organizohen për nder të kthimit të mërgimtarëve në vendlindje.

## GJUEJARËT KËRKOJNË REFORMA NË SHOQATËN "MALI SHARR"

# Kryetari me 20 vite pushtet!

Tetovë, 28 janar - Anëtarë të Këshillit nismëtarë të shoqatës së gjuetarëve "Mali Sharr" nga Tetova të pakënaqur me punën e deritashme të kësaj shoqate, me një letër ju drejtuan Kryesisë së shoqatës së gjuetarëve. "Për shkak të revoltës shumëvjeçare të një pjese të madhe të anëtarëve, si dhe për shkak të qëndrimit arrogant të Këshillit drejtues përkundër shumë kërkesave dhe sugjerimeve rreth udhëheqjes - të njëjtit nuk gjetën

kohë dhe forcë ti kryejnë detyrimet e veta ligjore, prandaj ne si Këshill nismëtar kemi vendosur të ndërmarrim procedurën e thirrjes së mbledhjes së Kuvendit të shoqatës së gjuetarëve 'Mali Sharr'. Në përputhje me Statutin e shoqatës, mbledhja e Kuvendit duhet të mbahet së paku një herë në vit. Edhe pse ky është detyrim i kryetarit dhe Këshillit drejtues, 20 vitet e fundit nuk është thirr asnjë mbledhje, thuhet në reagimin e

anëtarëve të Këshillit nismëtar të shoqatës së gjuetarëve "Mali Sharr" nga Tetova. Më tej, ata thonë se gati se 20 vite nuk është mbajtur zgjedhje. "Konsiderojmë se organet e shoqatës bëjnë keqpërdorim në dobi të tyre personale, bëjnë obstrukcione për organizim të zgjedhjeve duke shkelur të drejtat e anëtarësisë për të zgjedhur përfaqësuesit e vet në organet e shoqatës, pra kryetari dhe Këshilli drejtues 20 vjet janë në pu-

shtet në mënyrë të paligjshme, nuk janë legjitim dhe mbajnë përgjegjësi për cenimin e të drejtave të anëtarëve, prandaj konsiderojmë se ata nuk kanë të drejtë as të organizojnë zgjedhje, dhe kërkojmë që menjëherë të japin dorëheqje të përvokueshme nga të gjitha funksionet. Gjithashtu, me zgjedhjen e Kuvendit të ri të shoqatës duke marrë parasysh se 20 vjet nuk është thirr Kuvend dhe nuk është dhënë përgjegjësi - do

të kërkojmë të kryhet revizion i punës së deritashme dhe llogari për mjetet të cilat konsiderojmë se janë shpenzuar në mënyrë të paligjshme, e që më pas ato mjetet ti kthehen shoqatës", thuhet në letër, ndërsa njofton anëtarët dhe i trimëron ata që të mos kenë frikë dhe të mos u nënshtrohen presioneve, "por lirisht në numër të madh në momentin kur do të krijohen kushte, të vijmë e të votojmë. (U.H)

# Ligji për përdorimin e gjuhëve dhe argumentet në favor të tij



Nga  
Dr. Bekim KADRIU

Në kolumnën time të fundit të titulluar "Ligji për Përdorimin e Gjuhëve dhe Kampionati Evropian në Hendboll" zhvilloj dy teza. E para është se një pjesë e maqedonasve, duke përfshirë edhe disa intelektualë, për fat të keq, ende mendojnë se maqedonasit dhe shqiptarët nuk mund dhe nuk duhet të kenë status të barabartë në Republikën e Maqedonisë. Përkatesisht, ideja është se Maqedonia është shtet kombëtar i maqedonasve, ndërsa bashkësitë e tjera duhet të kenë statusin e pakicave. Megjithatë mund ta kundërshtojë dikush këtë tezë, e njëjta u konfirmua të dielën, në protestat e organizuara nga të ashtuquajturit "TvrdoKorni", në të cilat slogan kryesorë ishte se me Ligjin "humbet karakteri maqedonas i shtetit". Kjo ide e pengon Republikën e Maqedonisë të jetë një shtet i vërtetë qytetar gjë që reflektohet edhe në çështjen e gjuhës shqipe. Teza e dytë që unë zhvilloj në kolumnën e fundit, e cila bie në kundërshtim me të parën, është se Maqedonia është një shtet i qytetarëve të barabartë, qytetarë që iu përkasin bashkësive të ndryshme etnike, të cilët mund të flasin gjuhë të ndryshme. Përdorimi i gjuhëve në shtet si gjuhë zyrtare është një çështje që ligjvënësi e vendos, në përputhje me nevojën reale të qytetarëve, gjë që nuk e rrezikon fare karakterin qytetar të shtetit. Për më tepër, besoj se kjo mundësi do të kontribuojë më shumë për integrimin e qytetarëve shqiptarë në Republikën e Maqedonisë. Në këtë tekst, do të jap argumente në favor të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, duke iu referuar edhe disa kritikave kundër tij. Nga kritikët, nuk do të ndalem te ato që i pohojnë se Ligji për përdorimin e gjuhëve rrezikon karakterin unitar të shtetit (që teorikisht nuk mund të ndodhë) ose që zbatimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve do të jetë një barrë e madhe financiare për shtetin (natyrisht që ka, nëse një deputet në emër të shpenzimeve të udhëtimit për një vit mund të marrë 100,000 euro nga buxheti, mund të investohet edhe në përdorimin e gjuhës së bashkësisë që është 30% e popullsisë së përgjithshme dhe kontribuon në mbushjen e buxhetit. Mos të flasim edhe për tarifën e anëtarëve të KSHZ-së apo projektin mafioz Shkupi 2014.

## LIGJI PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE DHE "FLAMURI EVROPIAN"

Një kritikë e Ligjit është që është miratuar në procedurë të parashikuar për legjislacion me të cilin implementohet drejta e BE-së, dhe nuk ka asnjë

direktivë ose rregullore që vlen për gjuhët dhe që implementohet me këtë ligj. Është e vërtetë se nuk ekzistojnë direktiva apo rregullore të tilla. Por është gjithashtu e sigurt se Komisioni Evropian ka përsëritur në raportet e progresit të Republikës së Maqedonisë (Progress Reports) se është i nevojshëm avancimi i përdorimit të gjuhës shqipe në Maqedoni. Kështu, në Raportin e progresit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2014, Komisioni Evropian, duke diskutuar për prioritetet e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, shprehimisht pohon se "ka vend për përmirësime në fushën e mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë, përdorimit të gjuhëve dhe arsimit" (faqe 13). Nga kjo del se çështja e të drejtës së përdorimit të gjuhës shqipe, si pjesë e kriterit të gjerë politik për respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut (dhe i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit) është një nga çështjet që duhet të përmirësohet dhe të avancohet. Kur Parlamenti i Republikës së Maqedonisë miraton një ligj i cili është i nevojshëm për të përmbushur kriteret politike për anëtarësim në BE, është e nevojshme të mbajë flamurin Evropian dhe të zbatohen dispozitat e Rregullores së Punës së Parlamentit në lidhje me këto ligje.

Në anën tjetër, në Traktatin e Lisbonës si burim primar i së drejtës së BE-së, parashikohet që "Unioni të

njohë të drejtat, liritë dhe parimet e parashikuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian" (neni 6.1). Karta (si pjesë e Traktatit të Lisbonës) përcakton se "Unioni duhet të respektojë diversitetin kulturor, fetar dhe gjuhësor" (neni 22). Shtetet nuk kanë detyrim të respektojnë të drejtat e Kartës nëse nuk zbatojnë të drejtën e BE-së, por fakti që BE-ja promovon diversitetin gjuhësor absolutisht lë hapësirë për shtetet që ta përshtratin atë diversitet në kontekstin e tyre shoqëror. Republika e Maqedonisë bën pikërisht këtë.

## STANDARDET NDËRKOMBËTARE JANË STANDARDET MINIMALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Një argument tjetër që përdoret kundër Ligjit për përdorimin e gjuhëve është se gjuha shqipe duhet të ketë statusin e një "gjuhe të pakicës", ndërsa zgjidhja e pranuar shkon përtej asaj që përmbajnë standardet ndërkombëtare që i referohen përdorimit të gjuhëve të pakicave. Për këtë "argument", së pari duhet të thuhet se termi "pakicë" në rendin kushtetues të Republikës së Maqedonisë është i panjohur. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë përdor termin "bashkësi/komunitete", ndërsa para vitit 2002 është përdorur termi "nacionalitete". Dhe pohimi se 30% e popullsisë së Republikës së Maqedonisë duhet të traj-

tohet si pakicë (dhe kështu gjuha- si gjuhë "e pakicës") është me të vërtetë absurde.


Së dyti, të gjithë ata që merren me shkencën juridike ose politike, dhe jo vetëm ata, në mënyrë të qartë e dinë se standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (përfshirë edhe standardet që kanë të bëjnë me pakicat dhe gjuhën e tyre), janë standardet minimale dhe nuk ekzistojnë asnjë pengesë që një shtet të shkojë jashtë asaj dhe mbi atë që është e përcaktuar me këto standarde. Kështu, Karta Evropiane për Gjuhët Regjionale dhe të Pakicave parashikon se ajo (Karta) nuk ka ndikim në të drejtën kombëtare ose marrëveshjet ndërkombëtare që vendi ka ratifikuar, të cilat mund të kenë dispozita më të avancuara mbi statusin e gjuhëve në vend (neni 4). Kështu, pretendimi se gjuha shqipe duhet të ketë statusin e një gjuhe të pakicës nuk mban, mund të jetë vetëm dëshira e dikujt, por jo një pengesë për avancimin e përdorimit të gjuhës shqipe.

Së treti, dhe po t'a pranojmë se ndaj gjuhës shqipe duhet të zbatohen standardet ndërkombëtare në lidhje me gjuhën (e pakicave), ja Karta Evropiane për Gjuhët Regjionale dhe të Pakicave siguron përdorimin e gjerë të gjuhëve dhe, unë do të argumentoj se, ligji për përdorimin e gjuhëve është në masë të madhe në përputhje me

**Debati duhet të fokusohet në zbatimin e ligjit dhe pengesat e mundshme (teknike, financiare, kadrovike), jo me shpirtligësi dhe me teza sipërfaqësore të mohohet drejta e përdorimit të gjuhës shqipe. Sa më shpejt ta kalojmë këtë fazë, aq më shpejt do bindemi se kemi qenë në lajthim**



## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 28 janar | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

këtë Kartë. Për shembull, Karta parashikon një detyrim për shtetin që të sigurojë arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në gjuhën e komunitetit (neni 8). Sa i përket dy fushave specifike, Karta parashikon detyrimin e shteteve-palë që gjykatat të sigurojnë, me kërkesë të vetëm njëerës palë, që të zhvillojnë procedurën në gjuhën e bashkësisë në çështjet penale, civile dhe administrative "...courts, at the request of one of the parties, SHALL conduct the proceedings in the regional or minority languages" (neni 9). Pra, përsëris, të zhvillojnë procedurën në gjuhën e bashkësisë. Ligji për përdorimin e gjuhëve bën gjithashtu të njëjtën gjë. Njëjtë, sa iu përket organeve shtetërore, organeve lokale dhe rajonale, orgaen me autorizime publike (në pronësi publike dhe private, për aq kohë sa mbeten nën kontrollin publik, si zyrrat postale, spitalet, shërbimet e transportit, shërbimet komunale, etj) ekziston detyrim për shtetet-palë të sigurojnë këto organe, organizata, institucione, kompani, agjencione (pavarësisht nga emërtimi), të përdorin gjuhën e bashkësisë (që do të thotë vetë institucioni, në funksionimin e tij, të përdorë gjuhën e bashkësisë ("to ensure that administrative authorities use the regional or minority languages"); punonjësit në kontakt me anëtarët e komunitetit të përdorin gjuhën e komunitetit; të sigurohet që anëtarët e bashkësisë të mund të paraqesin shkresat dhe përgjigjet e tyre t'i dorzojnë gjegjësisht t'i pranojnë në gjuhën e tyre; të lejohen institucionet të hartojnë dokumente në gjuhën e bashkësisë (neni 10). Ligji për përdorimin e gjuhëve bën gjithashtu të njëjtën gjë. Në jetën ekonomike, Karta parashikon detyrim për shtetet-palë të sigurojnë që fletëpagesat, çeqet, kambialet, kontratat për punë dhe tjera, të jenë në gjuhën e bashkësisë (neni 11).

Dhe diçka tjetër. Kjo Kartë lejon një gjuhë tjetër të jetë gjuhë zyrtare në shtet, kur kërkohet që te dokumenti i ratifikimit shteti të përcaktojë se kush është gjuha rajonale, e pakicës apo gjuhë zyrtare që është më pak e përdorur në një pjesë apo në të gjithë vendin të cilës i referohen detyrimet e Kartës (...shall specify in its instrument of ratification...each regional or minority language, or official language which is less widely used on the whole or part of its territory...). Dispozitat e cituara sipas kësaj Karte, të miratuara në kuadër të Këshillit të Evropës, në pjesën më të madhe pranohen në Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Së bashku me faktin se këto janë standarde minimale, asgjë nuk pengon Republikën e Maqedonisë për të shkuar drejtë përmirësimit të përdorimit të gjuhës shqipe (si gjuhë zyrtare).

Por, këtu unë e parashtroj pyetjen: pse Republika e Maqedonisë ka nënshkruar Kartën 22 vite më parë (1996), dhe ende nuk e ka ratifikuar???

#### PËR KUSHTETUTSHMËRINË E LIGJIT PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

Kritika kryesore kundër Ligjit për përdorimin e gjuhëve është se i njëjti, të paktën në disa pjesë, qenka jokushtetues. Së pari, ajo që të gjithë e dinë, kushtetuta është një akt i përgjithshëm juridik dhe nuk mund të rregullojë marrëdhëniet shoqërore në detaje. Kushtetuta përcakton se gjuha shqipe (gjuha e folur nga 20% e qytetarëve) është gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë, por parasheh që është e nevojshme të miratohet një ligj që do të përcaktojë në cilat fusha dhe si do të përdoret gjuha shqipe si gjuhë zyrtare. Një ligj i tillë u miratua për herë të parë në vitin 2008. Askush nuk foli për atë se ligji ishte antikushtetues, edhe pse edhe ai shkonte përtej normës kushtetuese. Edhe ligji aktual shkon përtej normës kushtetuese, por kjo përcaktohet nga vetë Kushtetuta. Përkatësisht, Kushtetuta përsërit katër herë se duhet të miratohet një ligj për përdorimin e gjuhës shqipe. Një prej dispozitave kryesore të amendamentit V të Kushtetutës thekson se "në organet e pushtetit shtetëror në vend, si gjuhë zyrtare tjetër nga maqedonishtja, mund të përdoret në përputhje me ligjin."

Pra, po të donte kushtetutvënësi të mbetet vetëm në normë kushtetuese, nuk do të kishte paraparë miratimin e një ligji, por çështjen e përdorimit të gjuhës shqipe do ta rregullonte vetëm me kushtetutë. Sidomos kur bëhet fjalë për ligjet që rregullojnë çështjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, shtrirja e tyre (e lirive dhe të drejtave) me ligj nuk mund të konsiderohet jokushtetuese. E kundërta do të ishte më problematike, domethënë nëse liritë dhe të drejtat kushtetuese kufizohen me ligj, edhe pse një gjë 7 e tillë ekziston në Republikën e Maqedonisë. Vetëm si shembull, kur flet për të drejtën e votës, Kushtetuta numëron që një person të jetë madhorë, të ketë shtetësi dhe të mos jetë i privuar nga zotësia e veprimit (neni 22). Por, Kodi Zgjedhor parashikon kusht shtesë, dhe kjo është që qytetari të ketë, nga njëra anë vendbanimin të përhershëm në Republikën e Maqedonisë, dhe nga ana tjetër, për regjistrim në regjistrin zgjedhor, duhet të ketë letërnjoftim apo pasaportë të vlefshme (neni 41.4). Edhe pse kushtet e tilla nuk ekzistojnë në normën kushtetuese, asnjë nga këto kërkesa shtesë të Kodit Zgjedhor nuk konsiderohen ato jokushtetuese. Një shembull tjetër i kufizimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese me ligj është e drejta në privatësi nga neni 25 i Kushtetutës. Ky nen aspak nuk parashikon mundësinë e kufizimit, ndërsa Ligji për ndjekjen e komunikimeve, për shembull, lejon kufizim të privatësisë. Askush nuk pretendon se ky ligj është jokushtetues.

Për ta përmbledhur, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve e konkretizon normën kushtetuese të Amendamentit V të Kushtetutës. Një ligj i tillë ekziston që nga viti 2008, ndërsa Ligji i ri i propozuar zgjeron dhe avancojnë përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare. I njëjti nuk e barazon gjuhën shqipe me gjuhën maqedonase, që do të ishte në kundërshtim me paragrafin 1 të Amendamentit V, por vetëm e zgjeron përdorimin e saj në përputhje me nevojat e qytetarëve shqiptarë.

#### LIGJI MBI PËRDORIMIN E GJUHËVE NUK RREZIKON GJUHËT E BASHKËSIVË TJERA

Ligji mbi përdorimin e gjuhëve vetëm shtrin mundësinë e përdorimit të gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare. Ai nuk e rrezikon gjuhën maqedonase, e cila mbetet si gjuha e vetme zyrtare në përdorim të përgjithshëm. Ndërsa gjuha shqipe do të zbatohet vetëm në ato fusha që parashihen me ligj, dhe jo jashtë atyre fushave. Këtë e parasheh vetë ligji i propozuar, në nenin 1, paragrafi 3. Në të gjitha institucionet, qendrore dhe lokale, në të gjitha fushat dhe procedurat, gjuha maqedone mbetet e paprekur, ndërsa vetëm në ato fusha që parasheh ligji i propozuar, gjuha shqipe do të zbatohet së bashku me maqedonishten. Por gjuha maqedonase nuk përjashtohet në asnjë mënyrë. Kështu, ligji nuk bie ndesh me normën kushtetuese për gjuhën maqedonase si e vetmja gjuhë zyrtare në përdorim të përgjithshëm. Sa iu takon gjuhëve të bashkësisë më të vogla, dallimin në statusin e gjuhës shqipe me ta e bën vetë Kushtetuta kur parashikon se gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë është gjuha që flitet nga më shumë se 20% e popullsisë. Ky ligj e implementon këtë normë kushtetuese dhe nuk diskriminon gjuhët e tjera. Nëse gjuha shqipe, siç pretendohet, diskriminon gjuhët e tjera, atëherë gjuha maqedonase, me të njëjtën logjikë, diskriminon të gjitha gjuhët, duke përfshirë edhe gjuhën shqipe edhe gjuhët e bashkësisë më të vogla. Në fund, unë mendoj se debati duhet të fokusohet në zbatimin e ligjit dhe pengesat e mundshme (teknike, financiare, kadrovike), jo me shpirtligësi dhe me teza sipërfaqësore të mohohet e drejta e përdorimit të gjuhës shqipe. Sa më shpejt ta kalojmë këtë fazë, aq më shpejt do bindemi se kemi qenë në lajthim. Përdorimi edhe i një gjuhe tjetër në institucione ose në procedura nuk do të dëmtojë askënd.

Dhe gjuha nuk ndryshon thelbin e mendimeve dhe ideve. Ato mbeten të njëjta.

## Politika dhe futboli, lojë me...



Nga Xheladin MURATI

Politika është si futboli, por kultura politike dallon nga kultura në futboll. Si në futboll ashtu edhe në politikë ka rebelim, rrahje, përleshje, fyerje dhe sharje. Thjesht trazira. Në futboll ka lojtar njëloj si në politikë. Në futboll ka trajner, refer, sulmues, qendër-sulmues, mbrojtës, anësor, mesfushor. Edhe në politikë ka parti, kryetar, buldozer, sulmues, diplomaci, fushë mejdani, centrist, majtist, djathtist e të ngjashme. Njëloj si në futboll edhe në politikë duhet të ketë mbrojtës, sulmues, goditës i drejtpërdrejt dhe ato që e ndalin topin apo veprimin. Në futboll ka ekipe kundërshtarë kurse në politikë shumicë parlamentare dhe opozitë. Në politikë duhet të dihet të hidhet topi, të ndalet kur duhet dhe të godasësh në momentin e duhur, ashtu ndodh edhe në futboll. Të vetmen gjë të përbashkët kanë rregullat e lojës. A mund të krahasohet politika me futbollin? Politika dhe futboli, përballë njëra tjetrës? Edhe po edhe jo. Është gabim të krahasohet, por veprimet që bëhen në futboll dhe në politikë janë identike. Dallimi kryesor midis futbollit dhe politikës qëndron në moshën. Futbollisti duhet të jetë i ri, politikani i vjetër. Në futboll ka transfere, edhe në politikë njëloj. Në politikë ka eksperiencë të dështuara, edhe në futboll njëjtë. Edhe në politikë ka bashkëlojtarë dhe kundërshtar sikurse edhe në futboll. Në futboll ka klube, në politikë ka parti. Që të dyja kanë ambicie maksimalisht për shfrytëzimin e simpatizuesve dhe votuesve. Në futboll ka lojtar profesionist, në politikë ajo ndodh rrallë. Në politikë gjërat bëhen gjithnjë më serioze, kurse në futboll jo. Në futboll, minutazhi i lojës është caktuar, në politikë jo. Në futboll ka rendimente edhe pse ato nuk janë gjithnjë me pritshmëritë e klubit, kurse në politikë ka vendime që reflektojnë me pritshmëritë e partisë. Futbollistët lidhen me kontrata milionëshe, kurse politikanët me vendime zgjedhore nga qytetarët. Në futboll ka nevojë për mbështetje dhe motivim, në politikë përafërsisht është njëloj. Në futboll ka surpriza, në politikë surprizat janë të rralla, por në të dyja rastet sfiduese. Seancat politike zgjasin me vazhdimë, me ditë - kurse ato në futboll zgjasin shkurt dhe me mundësi vazhdimi dy here nga 15 minuta. Nëse në futboll ka lojë të bukur, dresa firmato, sjellje rivale kurse në politikë ka lojë të mirë, sjellje kundërshtuese pozitë-opozitë, veshje elegante, firmato, mbase edhe politika është lojë fjalësh me pasoja ose jo. Sikurse lojtarët që lënë gjurmë në futboll edhe politikanët lënë gjurmë, njëloj, për të keq apo për të mirë. Në politikë ka penalizim sikurse në futboll që ka penallti. Ka edhe shumë dallime mes futbollit dhe politikës. Futbollisti shitet dhe blihet për para të majme, kurse politikani mundohet të gjejë mënyra të vjen te para. Politika dhe futboli japin porosi për përmirësime dhe mënyra se si mund të përmirësohet vetëdija kombëtare e shoqërore, përpiqen të motivojnë simpatizuesit dhe votuesit, mbështetësit dhe kundërshtarët. Edhe në njërin edhe në tjetrën përdoren artileri të rënda për të çarë rrugën drejt suksesit e fitores.

Po ku dallojnë futbollisti nga politikani? Mund të gjejmë më shumë elemente, por tri janë kryesorët: futbollisti dallon në uniformën e quajtur dres, në topin si mjet themelor të lojës si dhe në referin (gjkatësin) e lojës. Politikani ka elegancën e veshjes, fjalën si mjet të lojës dhe kryeparlamentari që jep e merr fjalën. Së fundmi, politikani i vërtetë është gjithmonë në lëvizje, në kërkim të së resë, sikurse futbollisti, por nuk kanë shpirt binjak mes vete. Prandaj edhe politika edhe futboli janë një eksperiencë e shkëlqyeshme, por e vështirë, por për dallim nga politika futboli është një profesion më i kërkuar tek ne e në botë.

## Vozniacki, "mbretëresha" e re e "Australian Open"

Karoline Vozniacki është "mbretëresha" e re e "Australian Open". Tenistja daneze arriti të mposhte në finalen e turneut të Melbourne rumunen Simona Halep 2-1 me sete, 7-6, 3-6 dhe 6-4, në 2 orë e 49 minuta lojë. Ky është sukcesi i parë i 27-vjeçares në një grand slam. Vozniacki pas këtij triumfi në një finale mjaft të luftuar bëhet numri një në botë në renditjen e përgjithshme për femrat, duke zbritur nga froni pikërisht rivalen rumune Halep.



## Dinamo ofron 2.5 milionë euro për Grezdën

Eros Grezda është pa dyshim një nga lojtarët më të mirë dhe të talentuar që ka kombëtarja shqiptare për momentin. Çjakovari ka shkëlqyer me paraqitjet e tij si me kombëtaren, ashtu edhe me klubin në Koraci, Osijek. Këto paraqitje të mira dhe forma e shkëlqyer e Grezdës nuk kishin si t'u shpëtonin syve të agjentëve të merkatos. Mediat kroate raportojnë se sulmuesi shqiptar është objektivi kryesor i Dinamo Zagreb në këtë merkato dimri. Mësohet se klubi kryesor kroat ka hyrë në tratativa të avancuara me Osijekun dhe është i gatshëm të paguajë deri në 2.5 milionë euro për të bërë të tijin Eros Grezdën. Por jo vetëm kaq, pasi Dinamo Zagreb tenton të joshë gjakovarin edhe në një tjetër aspekt, t'i ofrojë atij një trefishim të pagës, që ai merr aktualisht tek Osijeku. Cekim, Eros Grezda u transferua nga Lokomotiva Zagreb te klubi aktual për shifrën e 500 mijë eurove.

# PARTIZANI BËN GODITJEN E FUNDIT PËR ABDURAHIMIN

Skuadra e Partizanit e nisi me humbje sezonin pranveror dhe pika më e dobët e saj është sulmi. Andaj drejtuesit e kësaj skuadre do të tentojnë që ta sjellin në radhët e tyre ish-futbollistin e Shkëndijës, Besart Abdurahimin. Në fakt ata do të bëjnë goditjen e fundit, pasi deri më tani disa herë kanë dështuar pasi sipas mediave nga Shqipëria nuk merreshin vesh rreth pagës



Shkup, 28 janar - Ishte shumë e hidhur dhe shkaktoi shumë polemika ajo penallti e shndërruar në gol në minutat e fundit nga Flamurtari. Partizani duket se nuk do ta kapërdijë lehtë atë pikë të humbur mbrëmjen e djeshme, në Vlorë. Të kuqtë e Starovës treguan nivel loje të kënaqshëm përballë Flamurtarit, edhe pse në fund nuk ia dolën të marrin pikë. Kjo gjendje e skuadrës, por mbi të gjitha klasifikimi, me vetëm 26 pikë në 17 ndeshje, është shumë pak për një ekip si Partizani, për objektivat që ka, por edhe investimet e kryera. Duke u nisur nga kjo situatë, ku pika më e dobët shikohet sulmi, drejtuesit e klubit kanë menduar të bëjnë një goditje të fundit në merkato. Emri që po qarkullon

në korridoret e të kuqve sipas mediave nga Shqipëria është Besart Abdurahimi. 27-vjeçari, ka qenë një nga më të mirët e Shkëndijës së Tetovës dhe pritët të jetë një përforsim shumë cilësor për ekipin e Sulejman Starovës. Pritet vetëm zyrtarizimi dhe Abdurahimi do të vihet nën urdhrat e "Bobit", i cili tashmë do të ketë një armë më shumë në sulm. Ndërkohë, në sulmin e Partizanit që nga kjo javë rikthehet edhe Edgar Çani. Ish-lojtari i kombëtares duket se e ka kaluar dëmtimin dhe do të rikthehet në stërvitje për të qenë gati për ndeshjen e ardhshme. Rikthimin e tij e ka konfirmuar edhe vetë tekniku Starova në daljen për mediat pas ndeshjes me Flamurtarin.

## FC SHKUPI NDRYSHON ORARIN DHE EKIPET

### Çelik dhe FC Okzetpes, kundërshtarët e ri

Shkup, 28 janar - Skuadra e FC Shkupi nga 22 janari po qëndron në Antali të Turqisë për të ngritur formën para fillimit të pjesës së dytë të sezonit futbollistik në Ligën e Parë të Maqedonisë. Deri më tani bardhekaltërit kanë zhvilluar dy ndeshje kontrolluese, ndaj Qarabagut të Azerbajxhanit (0-0) dhe Steel të Ukrainës (0-0). Ndryshe, nga klubi informojnë se agjencia që i organizon ndeshjet kontrolluese ka ndryshuar dy data dhe dy kundërshtarë. Fillimit me 31 janar Shkupi për kundërshtarë të do të ketë skuadrën boshnjake NK Çelik nga Zenica, me 2 shkurt mbetet e pandryshuar ndeshja ndaj Çernomorets Odessa nga Ukraina, ndërsa me 4 shkurt në vend të Anzhit rus, Shkupi luan ndaj ekipit të Premier Ligës së Kazakistanit,



FC Okzhetpes. Ndërkohë, nga klubi gjithashtu njoftuan se Stefan Vujçiç, i cili deri më tani është stërvitur individualisht pas rikthimit nga lëndimi, prej dje i është bashkuar pjesës tjetër të skuadrës.

## Sadiku titullar dhe gol në miqësore me Legian

Një luftëtar dhe goleador. Këto janë veçoritë me të cilat Armando Sadiku rifitoi Legian e Varshavës. Nga një lojtar që në fillim të merkatos së janarit u përfol se do të largohej, në titullar dhe gola-shënues të ekipit më të madh polak. Sulmuesi shqiptar vazhdon të shkëlqejë në miqësoret që skuadra e tij po zhvillon gjatë minifazës përgatitore. Pas dëmtimit të ish-sulmuesit të përfaqësueses kroate, Dinamos së Zagrebit, Arsenalit dhe Shakhtar Donjeckut, Eduardo Da Silva, kuqeziu u kthye në titullarin e skuadrës. Besimin e dhënë nga stafi teknik, Sadiku e shpërbleu menjëherë me paraqitje të shkëlqyera në lojë dhe tashmë me gol. Bomberi shqiptar ishte titullar në miqësoren ku Le-



gia e Varshavës fitoi 2-0 përballë danezëve të Silkeborgut. Sadiku ishte rreziku më i madh në zonën kundërshtare dhe në minutën e 32-të realizoi golin e avantazhit për polakët. Një pjesë loje i mjaftoi kuqeziu që të konfirmojë se është një element mjaft i rëndësishëm te Legia dhe se në gjysmën e dytë të sezonit do të rivalizojë me Eduardon për fanellën e titullarit.

# 5 OPERACIONET MË TË DËSHTUARA DHE MË TË SUKSESSHME TË HISTORISË SË FUTBOLLIT



Në vitin 2002, Interi e lejoi dy herë fituesin e Çampions Ligës në atë kohë të largohej te rivalët e Milanit në këmbim të Koko, mbrojtës. Sidorf fitoi edhe dy Çampions Liga të tjera dhe dy tituj në kampionat me Milanin, ndërsa Koko flitet se po punon si agjent i pasurive të patundshme

Merkato e futbollit na ka mësuar më operacione të jashtëzakonshme, të papritura dhe të realizuar në minutën e fundit. Në historinë e shitblerjes së lojtarëve ka pasur disa këmbime të realizuara mes klubeve që kanë shkruar historinë e futbollit. Këto janë pesë prej tyre:

## BARCELONA-INTER

### ETO'O + 40 MLN EURO PËR IBRAHIMOVIÇ

Pep Guardiola, në mënyrë të papritur, vendosi të shpërbente ekipin e 2009-ës që fitoi "Tripletën"

nën urdhrat e tij. Ai jo vetëm që vendosi ta këmbente Eto'o, por i pagoi edhe 40 milionë euro Interit për të marrë shërbimet e Zlatan Ibrahimoviç. Eto'o, siç dihet tashmë, fitoi gjithçka me Interin sezonin pasardhës, ndërsa mes Zlatan dhe Pep u krijua një pakënaqësi që vazhdon akoma sot.

**Fitues: Inter**

## BARCELONA-PORTO

### KUARESMA + 15 MLN EURO PËR DEKO

Deko ka qenë një nga lojtarët më të kërkuar në Evropë në verën e

2004-ës. Sapo kishte fituar Çampions Ligën me Porton dhe kishte arritur finalen e Euro 2004 me Portugalinë. Barcelona ofroi Kauresman, një lojtar premtues në atë kohë dhe 15 milionë euro. Deko fitoi dy kampionate në Spanjë, dy Superkupa dhe një Çampions Ligë tjetër. Kuaresma, nga ana tjetër, ka mbetur një premtim i papërmbushur.

**Fitues: Barcelona**

## ÇELLSI-ARSENAL

### GALLAS + 6 MLN EURO PËR KOLL

Eshli Koll është bërë një

legjendë e Çellsit, duke fituar kampionatin, katër kupa dhe Çampions Ligë, ndërsa Gallas pati probleme me shokët e skuadrës dhe u ul në mes të fushës pas një humbje të pësuar kundër Birmingem.

**Fitues: Çellsit**

## ÇELLSI-BENFIKA

### MATIÇ + 22 MLN EURO PËR LUIZ

David Luiz po shkëlqente te Benfika, ndërsa Matić nuk e kishte arritur akoma potencialin e tij. Pas atij këmbimi, të dy kanë luajtur bashkë te Çellsit dhe kanë qenë

protagonistë në fitoren e titullit në sezonin 2016/17.

**Fitues: Çellsit**

## INTER-MILAN

### SIDORF-FRANÇESKO KOKO

Në vitin 2002, Interi e lejoi dy herë fituesin e Çampions Ligës në atë kohë të largohej te rivalët e Milanit në këmbim të Koko, mbrojtës. Sidorf fitoi edhe dy Çampions Liga të tjera dhe dy tituj në kampionat me Milanin, ndërsa Koko flitet se po punon si agjent i pasurive të patundshme.

**Fitues: Milan**

## Për titull kam 3 rivalë



Fernando Alonso, Sebastian Vettel dhe Maks Verstappen. Këta do të jenë tri kandidatët kryesorë për Luis Hamilton në sfidën për titullin kampion në Formula 1 për vitin 2018. "Jemi katër kandidatë për titull dhe që të katërt janë shumë të fortë.

Përveç meje, ata janë Fernando Alonso, Sebastian Vettel dhe Maks Verstappen", ka qenë deklarata e pilotit britanik të Mercedes, që vjet fitoi titullin e katërt kampion bote në Formula 1 me makinën gjermane. "Janë katër pilotë me karakteri-

stika të ndryshme. Sebastian duket sikur të jep më shumë hapësira dhe nuk e them këtë gjë në sensin negativ. Maks rrezikon shumë dhe je ti ai që duhet t'i japësh më shumë hapësira, por është më pak ekspert se të tjerët.

Ndërsa Fernando është piloti më i fortë që ekziston në circuit, kam shumë respekt për të, por për ta mundur duhet të përdorësh të gjitha mënyrat e mundshme. Uroj që të 4 të jemi deri në fund në garë për titull, do të ishte diçka fantastike", deklaroi Hamilton.

## RONDA ROUSEJ MOHON KALIMIN NË "WWE"

# NIS XHIRIMET E NJË FILMI NË KOLUMBI

Kush priste që Ronda Rousej të debutonte fundjavën që e lam pas në "Royal Rumble" në sportin e "WWE" (World Wrestling Entertainment) gabohet, pasi ikona e arteve marciale mikse ende nuk ka vendosur të ngjitet në ring për të debutuar aty. Ish-kampionia e botës në UFC ka deklaruar se nuk ka firmosur asnjë kontratë për të kaluar në "WWE" edhe pse kërkesat nga ky sport janë të mëdha.

"I vlerësoj të gjitha fjalët e mia, por nuk ka firmosur gjë dhe aktualisht jam duke u nisur për udhëtim në Kolumbi, për të përfunduar xhirimet e filmit 'Mile 22', ka thënë për televizionin amerikan "TMZ" ish-sportistja e arteve marciale mikse Ronda Rousej, duke munguar kështu në evenimentin e së dielës "Royal Rumble" që u mbajt në Filadelfia. "Nuk kam firmosur asnjë letër edhe pse njerëzit flasin shumë thashetheme. Asnjë firmë në letër nga ana ime", tha më tej Rousej, që ka postuar më pas në faqen e saj zyrtare "Instagram" edhe një foto nga Bogota, në Kolumbi, ku ndodhet për xhirime. Ajo nuk zhvillon një sfidë që prej 30 dhjetorit 2016, kur humbi duelin me Amanda Nunes dhe nuk dihet se në cilën disiplinë sportive do të jetë e ardhmja e saj.



## EGZONA JASHARI, FUTBOLLISTE

Egzona Jashari, një vajzë e hareshme dhe gazmore, për gazetën KOHA, zbulon edhe detaje tjera para se të fillon të merret me futboll. Në fakt, ajo në fillim është marr me karate, pastaj me hendboll që më pas të fillon të merret me atë që siç tha e inspiron për tu mos u dorëzuar, pra sporti i futbollit



# E "ÇMENDUR" PAS FUTBOLLIT



Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 28 janar - "Futbolli nuk është vetëm një sport, është diçka më tepër që më inspiron mua për tu mos u dorëzuar në gjërat që i dua dhe i filloj", kështu e fillon rrëfimin e saj për gazetën KOHA, Egzona Jashari, futbollistja e KFF "Tetova". Egzona, një vajzë e hareshme dhe gazmore, për gazetën KOHA, zbulon edhe detaje tjera para se të fillon të merret me futboll. Në fakt ajo në fillim është marr me karate, pastaj me hendboll që më pas të fillon të merret me atë që siç tha e inspiron për tu mos u dorëzuar, pra sporti i futbollit. "Dëshira për sport për mua vjen nga fëmijëria. Jam dashamirë e sportit, por edhe që është më e rëndësishmja, rrjedh prej një familjes sportdashëse (tezja është marr me karatë) të cilët nuk më ndaluan të vazhdoj në rrugëtimin që e fillova si e re. Në fillim jam marr me karate te KK "Shogun" ku trajner e kisha Daut Bilibanin, një trajner i cili siç e dini arriti të zbulojë shumë talent të këtij sporti. Por sinqerisht sportin e karatesë e kisha vetëm si hobi prandaj nuk vazhdova shumë të merrem me këtë sport", filloi rrëfimin e saj Egzona.

**PJESË E KH "ÇAIR"**

Pasi braktis karatenë, Egzona filloi të merret me hendboll edhe atë si portiere e KH "Çair". "Me hendboll fillova të merrem nga viti



2007 kur edhe u themelua klubi i parë i hendbollit për femra 'Çair' edhe atë nën drejtimin e Mia Islami, ku unë por edhe vajzat që kanë qenë dhe janë pjesë e këtij klubi, duhet të jenë mirënjohës për punën dhe kontributin që e jep ajo. Këtu qëndrova shtatë vite dhe më pas u transferova te KH 'Universi' në Ligën e parë. Isha një portiere e dalluar dhe me paraqitjet që i bëra, për shërbimet e mia filloi të interesohet KH 'Vardar'. Por, lëndimi i hundës ku më pas kisha edhe një intervenim kirurgjik, pengoi që ky transferim të realizohet", vazhdoi më tej 23 vjeçarja nga Shkupi.

**NGA HENDBOLLI TEK FUTBOLLI**

Fakti që nuk u realizua transferimi te KH "Vardar" ndoshta doli më mirë për Egzonën, pasi pas kësaj ajo filloi të merret me atë që më së shumti ia donte zemra, sportin e futbollit. ishte 17-vjeçe dhe hapat e parë i ka bërë si nxënëse e

shkollës së mesme "Llazar Licenoski". "Hapat e parë me futbollin i kam bërë në shkollë të mesme kur u kyça në ekipin e shkollës 'Lazar Licenoski'. Aty u zgjodha lojtarja më e mirë dhe njëkohësisht isha kapitenë e ekipit. Nëpër ndeshjet që i zhvilloja, kisha zgjuar interesimin e klubeve të Ligës së parë 'Edinstven' dhe 'Dragon', gjë që edhe ndodhi por me këta dy klube zhvillova vetëm seanca stërvitore. Arsyja se pse nuk luajta ishin studimet në Universitetin Shtetëror të Tetovës, pasi nuk mundesha ti ndjek njëkohësisht edhe trajnimet edhe studimet".

**"AS UNITED" KLUBI I PARË, TANI TE KFF "TETOVA"**

Pasi dështoi transferimi fillimisht te "Edinstven" dhe "Dragon", Egzona arriti marrëveshje me skuadrën e "AS United" nga Struga. "Pasi ndërpreva bashkëpunimin me dy klubet 'Edinstven' dhe

'Dragon', fillova bisedimet me skuadrën e 'AS United' nga Struga. Trajneri Astrit Merko më mundësoi që të jem pjesë vetëm për ndeshje pa i ndjekur stërvitjet e tyre. Arritëm marrëveshje dy vjeçare dhe gjatë këtyre dy viteve ku luaja si mesfushore defensive, fillova një eksperiencë të mirë", pohon Egzona, e cila tani mbron ngjyrat e KFF "Tetova". Pas themelimit të klubit KFF "Tetova" mora ftes nga trajnerët Shpëtim Kuçi, Atita Loki, Valon Ameti dhe Suzana Sinadinoska, të jem pjesë e këtij klubi, gjë që edhe ndodhi. Aktualisht jam pjesë e këtij klubi dhe ndjehem shumë mirë. Luaj si mesfushor defensive, por nganjëherë edhe luaj në mbrojtje. Këtë sezon jemi angazhuar të gjithë që sa më shpejtë ti shijojmë sukseset, pasi stafi teknik po e bën një punë të madhe".

**STUDIMET DHE MARTEJA**

Ndryshe Egzona është e martuar, ndërsa është në prag edhe të përfundimit të studimeve. Por, ajo

zbulon një dëshirë të cilën për fat të keq nuk i është realizuar. "Duke parë dashurinë e madhe që kisha për futbollin, dëshiroja që dasmën ta bëj në stadium, në fushën e gjelbër. Mirëpo, për fat të keq kjo nuk ndodhi, dhe e tëra që arrita ta bëj ishte një fotosesion dhe një dokumentar të shkurtë që e bëra te stadiumi i FC Shkupi. Atë që dua të përmend është se kam përkrahjen e madhe të bashkëshortit Ilirit, i cili në çdo ndeshje vjen dhe më përcjell. Ai gjithashtu më përkrah edhe në studimet, ku jam në prag të përfundimit në USHT". Në fund Egzona tregoi edhe synimet e saja. "Dëshiroj që një ditë të luaj për ndonjë klub jashtë Maqedonisë. Sigurisht se për këtë nevojitet punë, por duke e njohur karakterin tim, besoj se kjo do të ndodh një ditë. Në fund dëshiroj që të falënderoj edhe rektorin e Universitetit të Tetovës Vullnet Ametin për përkrahjen që po ia jep klubit dhe atyre si dhe profesore-shës Shpresa Memishi", përfundoi Egzona Jashari.



# NUK KEMI PARA PËR 22 LOJTARË TË NIVELIT TË LARTË



"Sot, për të pasur 22 lojtarë të nivelit të lartë për të cilët keni nevojë, njerëzit ndoshta nuk do të më besojnë, por duhen shumë para gjë të cilën ne nuk e kemi. Për të rivalizuar në nivele të larta në të katër komepcionet, duhen 22 lojtarë të nivelit të lartë dhe sot këta 22 lojtarë janë aq të shtrenjtë saqë është e pamundur t'i kesh", pohon Guardiola

Pep Guardiola deklaroi se duhen 22 lojtarë të nivelit të lartë për të qenë konkurrent në të gjitha garat, por shton se tencenda aktuale e çmimit të tyre e bën të pamundur që Mançester Siti të ketë një organikë të tillë. "Qytetarët" kryesojnë me 65 pikë në Premier Ligë me një avantazh prej 12 pikësh nga ndjekësi më i afërt, Mançester Junajted, janë kualifikuar në finalen e "Carabao Cup", janë në garë për "FA Cup" dhe në

Ligën e Kampioneve, ndaj mund të aspirojnë për çdo trofe të mundshëm këtë sezon. "Nëse garoni në katër komepcione, duhet të luftoni për të qenë aty, duhet të jeni me fat të mos keni dëmtime ose duhet të keni 22 lojtarë të nivelit të lartë për të qenë konkurrenues në të gjitha komepcionet. Sot, për të pasur 22 lojtarë të nivelit të lartë për të cilët keni nevojë, njerëzit ndoshta nuk do të më besojnë, por duhen shumë para gjë të cilën ne

nuk e kemi. Për të rivalizuar në nivele të larta në të katër komepcionet, duhen 22 lojtarë të nivelit të lartë dhe sot këta 22 lojtarë janë aq të shtrenjtë saqë është e pamundur t'i kesh", shpjegoi Guardiola në konferencën e shtypit. Ndërkohë, trajneri spanjoll theksoi se kjo vlen për disa skuadra. "Ne nuk e dimë se çfarë do të ndodhë, por nuk kemi paguar më shumë se 100, 90 apo 80 milionë euro për një lojtar. Nuk mund të

paguajmë më shumë se kaq më ka komunikuar bordi i klubit, janë pagat, është një buxhet të cilin ne nuk mund ta kalojmë. Kjo është e vërteta, dhe për të qenë konkurrent në të katër komepcionet, në kohën kur nuk keni rikuperuar dhe jeni të detyruar të luani çdo tri ditë, atëherë keni nevojë për 22 lojtarë të nivelit të lartë dhe me ato të ardhura që kemi sot është e pamundur t'i kesh", përfundoi Guardiola.



## Aubamejang-Arsenal, operacioni drejt dështimit!

Kalimi i Pierr Emerik Aubamejang te Arsenali në këtë merkato po kthehet në një çështje. Kur mbeten edhe pak ditë që dritarja e transferimeve të dimrit të mbyllet ka gjasa që ky operacion merkatoje të dështojë. Borussia Dortmundit ka dalë me një deklaratë për shtyp nëpërmjet drejtorit sportiv Mikael Zork i cili ka theksuar se oferta e fundit e londinezëve për sulmuesin nga Gaboni është e pamjaftueshme. Për ta lënë të lirë sulmuesin klubi nga "Signal Iduna Park" kërkon 70 milionë euro ndërsa Arsenali për momentin nuk ofron më shumë se 60 milionë euro.

## Al-Khelaifi sulmon Realin për çështjen "Neymar"



Presidenti i Paris Sen-Zhermenit Nasser Al-Khelaifi ka deklaruar se nuk ka asnjë mënyrë që Neymar të largohet nga Parisi këtë verë, dhe ka sulmuar Real Madridin për tentativat për të destabilizuar skuadrën franceze në prag të ndeshjes së radhës në Çampionët Ligës. Neymar ka shënuar 26 gola në 24 paraqitje për skuadrën parisienë pas mbërritjes së tij 222 milionë eurosh nga Barcelona, por gjërat nuk kanë shkuar edhe aq mirë për brazilianin. Ai është përplasur me Edison Kavanin në fillim të sezonit, dhe së fundmi është fërshëllyer nga një sektor i tifozëve të klubit në "Parc des Princes" ai ka humbur disa

ndeshje të kampionatit së fundmi dhe thashethemet për një largim të tij janë rritur. Por duke folur pas fitores 4-0 ndaj Montpellier të shtunën — ku Neymar shënoi dy gola, Al-Khelaifi ka shënjestruar kampionët e Evropës. "Neymari te Real? Me siguri e keni parë sesa i lutur dukej në fushë", shprehet presidenti për "Canal+". "Ai është shumë i lumtur në Paris, po ashtu edhe familja e tij. Kemi një ndeshje të rëndësishme ndaj Realit. A është një tentativë për të na destabilizuar? Mbase, por nuk mendojmë për këto gjëra. Neymar nuk do të largohet në fund të sezonit. Në asnjë mënyrë!", përfundoi Al-Khelaifi.

## Bajerni nxjerr Vidalin në shitje

Bajern Munihi është gati të nxjerrë në shitje mesfushorin kilian Arturo Vidal verën e ardhshme dhe Mançester Junajtedi është gati të përfitojë nga rasti për të marrë lojtarin. Junajted ka kohë që ka dashur ta kryejë këtë transferim, që kur lojtari luante me Juventusin, që më pas përfundoi te bavarezët. Por e përditshmja gjermane "Bild" bën me dije se tashmë lojtari mund të largohet, pasi nuk ka më hapësirë për të luajtur, pas transferimit të Leon Goretzka te kampionët e Bundesligës. Dhe



skuatrat e Mançester Junajtedit e Çellsit janë dy kandidatët për ta marrë lojtarin. Trajneri Antonio Conte ka kohë që ka thënë se e dëshiron lojtarin në skuadër, por tashmë në garë është future edhe Junajted, duke kërkuar të bindë Vidal përmes ish-shokut të skuadrës Pogba dhe patriotit të tij Sançez. Gjithsesi, Vidal nuk është objektiv i vetëm për "djajtë e kuq", pasi në rast se dështon transferimi i kilianit, në shënjestër është edhe mesfushori i Napolit, Faouzi Goullam.

## Enrike nëse ikën Conte

Luis Enrike është në "pole position" për të qenë trajneri i ardhshëm i Çellsit nëse Antonio Conte do të largohet nga "blutë" e Londrës në fund të këtij sezoni. Mediat britanike bëjnë me dije se trajneri spanjoll është në krye të një liste kandidatësh për të zëvendësuar italianin. Enrike këtë sezon është pushim, pasi u largua një vit më parë nga stoli i Barcelonës dhe është shprehur se pas një sezoni pushim është gati për t'u rikthyer aktiv. Gjithsesi, në garë për të marrë stolin e Çellsit janë edhe trajneri Massimiliano Allegri e Diego Simeone, që gjithashtu janë kandidatë në rast se Conte vendos të largohet nga kampionët aktualë të Premier Ligës. Por emri i Enrikes është i preferuari i Roman Abramoviç, me spanjollin që ka fituar dy tituj kampionë në La Liga dhe një Çampionët Ligë me Barcelonën para se të largohet. Ardhja e tij të Çellsit do të zyrtarizohet para qershorit.



Disa nga qytetarët e asaj pjesë e pranojnë se nuk e paguajnë ujin, madje sipas tyre, duke e konfirmuar edhe atë që e thonë në ujësjellës, se për shpenzimet e bëra, nuk u shkojnë fare as faturat. Njëri nga ta është Vitomir Zhivkoviq nga Mitrovica veriore. Ai thotë se nuk e di se kujt duhet t'ia paguajë faturat për ujin

# TE SERBËT, ÇMIMI I UJIT MË I LIRË, POR ASKUSH S'PAGUAN



Banorët e komunave veriore të Kosovës, që nga përfundimi i luftës së fundit në Kosovë, nuk i kanë paguar faturat për shërbime të ujit. Rreth 700 mijë euro në vit apo më se 13 milionë euro për 19 vjet, llogaritet vlera e faturave të ujit të shpenzuar, e të cilat nuk paguhen nga banorët e këtyre komunave. Katër komunat: Leposaviqi, Mitrovica Veriore, Zubin Potoku dhe Zveçani, janë të banuara me shumicë serbe, të cilat ndër vite kanë funksionuar jashtë sistemit juridik-kushtetues të Kosovës. Hysni Feka, ushtrues detyre i udhëheqësit të Departamentit të tarifave në Autoritetin Rregullator për Shërbimin e Ujit (ARRU), thotë për Radion Evropa e Lirë se gjatë një viti, mbi katër milionë metra kub ujë janë dërguar në atë pjesë, me një çmim prej 0.17 euro centë, për metër kub. Kurse, çmimi i ujit për një metër kub, sipas tij, për konsumatorët e pjesës jugore, është rreth dyfish më e lartë. Faturat e shpenzuara të ujit, sipas Hysni Fekës, nuk arrijnë të konsumatorët që banojnë në atë pjesë. "Kompania rajonale 'Mitrovica', e mat ujin përmes tre ujëmatësve, në baza mujore. Raporton në ARRU, se sa ujë ka shkuar në pjesën veriore. Mirëpo, nuk ka një mekanizëm apo nuk ka një metodë, me të cilën kompania rajonale e ujit ta dërgojë fa-

turën te pranuesi i faturës. Nuk ka dikush që e pranon faturën e ujit nga ujësjellësi 'Mitrovica', thotë Feka. Edhe disa nga qytetarët e asaj pjesë e pranojnë se nuk e paguajnë ujin, madje sipas tyre, duke e konfirmuar edhe atë që e thonë në ujësjellës, se për shpenzimet e bëra, nuk u shkojnë fare as faturat. Njëri nga ta është Vitomir Zhivkoviq nga Mitrovica veriore. Ai thotë se nuk e di se kujt duhet t'ia paguajë faturat për ujin. "Ende nuk kemi marrë asgjë zyrtarisht. Kështu që deri më sot nuk kemi paguar. Do të paguajmë sikur ta dinim kujt t'ia paguajmë dhe të marrim vërtetimin se kemi paguar", thotë Zhivkoviq. Ndërkaq, Slavica Marinkoviq, qytetare po nga Mitrovica, thotë se nuk i kujtohet se kur ka paguar për herë të fundit për ujin e shpenzuar: "Në fakt, nuk e di se kur e kam marrë për herë të fundit faturën për ujin

dhe madje nuk e di se a ekziston matësi i gjendjes së shpenzimit të ujit në banesën ku jetoj". Ndryshe, Kompania Rajonale, Ujësjellësi "Mitrovica", që gjendet në Shipol, është e vetmja kompani e licencuar që kryen veprimtarinë e furnizimit me ujë të pijshëm dhe mirëmbajtjen e kanalizimit në rajonin e Mitrovicës, ku përfshihen komunat e banuara me shumicë serbe. Kjo kompani është nën ombrellën e Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit. Për mospagesën e faturave të shpenzuara të ujit, nga banorët e asaj pjesë, institucioni i Avokatit të Popullit, vitin e kaluar ka hapur hetim zyrtar. Avokati i Popullit, Hilmi Jashari, tregon për Radion Evropa e Lirë se për këtë çështje, ka biseduar me autoritet kompetente dhe pret veprime të drejta. Në të kundërtën, thotë ai, ky institucion do të dalë me një qëndrim publik se a ka të

bëjë me shkelje të të drejtave të njeriut. Shqetësuese, sipas Jasharit, përveç mospagesave të faturave, mbetet çmimi i ndryshëm i ujit për pjesën veriore dhe pjesën jugore. "Nëse nuk ka ndonjë veprim, atëherë ne, si institucion i Avokatit të Popullit, gjithsesi do të dalim me ndonjë qëndrim, raport dhe me rekomandime konkrete dhe do të vlerësojmë se a ka pasur shkelje të ligjit apo jo", thotë Jashari. Por, vazhdon të mbetet dilemë se kush e bënë pagesën e këtyre faturave për ujin e shpenzuar në katër komunat veriore? Hysni Feka thotë se Qeveria e Kosovës pothuajse për çdo vit bën subvencionim në shumën të ndryshme financiare në mënyrë që të mundësohet operimi i kompanisë. "Këtë pagesë nuk e bën askush, kjo çështje ka mbetur pezull. Mirëpo, për të mundësuar operimin e kompanisë, Qeveria në baza të rregullta

vjetore, por jo gjithmonë në shumën të njëjta, paguan shpenzime ekstra për vazhdimin e veprimtarisë së kompanisë 'Mitrovica', thotë Feka. Por, ekspertë për çështje ekonomike thonë se paratë me të cilat Qeveria e Kosovës po e subvencionon kompaninë rajonale "Mitrovica", janë taksa të qytetarëve të Kosovës. Naim Gashi, ekspert për çështje ekonomike, për Radion Evropa e Lirë, thotë se qytetarët nga pjesë ndryshme të Kosovës paguajnë faturat e ujit të shpenzuar në pjesën veriore. "Në fakt, praktika që rryma dhe uji i shpenzuar në veri të paguhet nga taksapaguesit kosovarë, mendoj se është një padrejtësi elementare, e cila iu bëhet qytetarëve të Kosovës dhe bie ndesh me të gjitha konventat dhe standardet ndërkombëtare. Është pabarazi, edhe sociale, edhe qytetare, që një pjesë e qytetarëve t'ia paguajnë faturat, ndërsa pjesa tjetër të mos i paguajë. E minojnë shtetin e Kosovës dhe njëkohësisht me taksat e qytetarëve të Kosovës, paguhen faturat e qytetarëve në veri", thotë Gashi. Subvencionimi për shpenzimet e ujit për konsumatorët e asaj pjesë nga Qeveria e Kosovës, konsiderohet si zgjedhje e papërshtatshme, edhe për Avokatin e Popullit, Hilmi Jashari. Për shkak të mospagesës dhe borxheve, në viset tjera kompanitë e ujit zakonisht aplikojnë masa ndëshkuese, duke i shkyçur nga rrjeti konsumatorët borxhlinj. Por, një gjë e tillë nuk ndodh në veri. Hysni Feka potencion faktin se problemi i mospagesës së faturave të ujit nga banorët e pjesës veriore, është, sipas tij, problem politik. Ai tregon se kompania rajonale "Mitrovica", për shkak të borxheve ka tentuar disa herë t'i shkëpusë nga rrjeti i furnizimit të ujit banorët e asaj pjesë, por që gjithmonë ka ndërhyrë politika. Përveç mospagesës së faturave të ujit të shpenzuar, banorët e kësaj pjesë, nuk paguajnë as faturat e energjisë elektrike, që llogariten 8 milionë euro në vit. (REL)

## SITUATA NË VERIUN E MITROVICËS ËSHTË E QETË

Së fundi janë shtuar deklaratat që në veri të Kosovës, gjendja e sigurisë është jo stabile. Për këtë zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj i ka quajtur kërcënim deklaratat e ministrit të Mbrojtjes së Serbisë, Aleksander Vulin. Përmes një postimi në llogarinë e tij në Twitter, Hoxhaj ka shpërndarë shkrimin ku Vulin thotë se është në kontakt me shërbimet përkatëse të



Gjermanisë për sigurinë e serbëve në veri të Mitrovicës. Këtë deklaratë Hoxhaj e quajtur kërcënim ndaj sigurisë së Kosovës dhe ndërhyrje për destabilizim në vend. "Gjendja në pjesën veriore të Kosovës është e qetë dhe e qëndrueshme. Institucionet përgjegjëse për siguri janë Policia e Kosovës, FSK-ja, EULEX-i dhe KFOR-i", ka shkruar Hoxhaj.

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, Marrëveshjes kolektive dhe Ligjit për arsim fillor dhe të mesëm, Shkolla shtetërore për muzikë – Manastir publikon:

### SHPALLJE

Për pranim të punëtorëve në vendet e punës në vijim

1.	Mësimdhënës për piano .....	9 realizues
2.	Korepetitor .....	1 realizues
3.	Mësimdhënës për saksofon.....	1 realizues
4.	Mësimdhënës lëndë teorike muzikore .....	1 realizues
5.	Mësimdhënës për violinë .....	1 realizues
6.	Mësimdhënës për histori të artit .... 2 orë mësimore	1 realizues
7.	Mësimdhënës të estetikës .....	3 orë mësimore
8.	Mësimdhënës të gjuhës italiane .....	4 orë mësimore
9.	Mësimdhënës të gjuhës frënge .....	8 orë mësimore
10.	Mësimdhënës të gjuhës angleze .....	8 orë mësimore

- Kandidatët prej numrit rendor 1 deri në numrin rendor 10 krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Ligjin për arsim fillor dhe të mesëm, duken të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të përmbajtura në normativin për kuadër mësimor.
- Orari i punës për të gjitha vendet e punës të theksuara në Shpallje fillon prej ora 7 ndërsa përfundon në ora 15 çdo ditë pune prej ditës së hënë deri ditën e premte.
- Për vendin e punës me numër rendor 1 dhe 3 pagesa bazë është 23056,00 denarë.
- Për vendin e punës me numër rendor 2, 4 dhe 5 pagesa bazë është 22101,00 denarë.
- Për vendin e punës me numër rendor 6 – mësimdhënës të historisë së artit me 2 orë mësimore, pagesa bazë është 2 155,00 denarë.
- Për vendin e punës me numër rendor 7 – mësimdhënës të estetikës me 3 orë mësimore, pagesa bazë është 3 232,00 denarë.
- Për vendin e punës me numër rendor 8 – mësimdhënës të gjuhës italiane me 4 orë mësimore, pagesa bazë është 4 310,00 denarë.
- Për vendin e punës me numër rendor 9 i 10 – mësimdhënës të gjuhës frënge dhe mësimdhënës të gjuhës angleze me 8 orë mësimore pagesa bazë është 8 620,00 denarë.
- Kandidatët do të pranohen për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018.
- Të gjithë kandidatët e paraqitur do të nënshtrohen kontrollimit të njohjes së gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik.
- Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune duke llogaritur nga dita e parë e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes në shtypin ditor.
- Zgjedhja do të realizohet në afat prej 30 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.
- Dokumentet të dorëzohen personalisht në shkollë ose përmes postës në adresën: "Shkolla shtetërore e muzikës" rr. "Bulevardi 1 Maj" nr. 110 – Manastir, me shenjë – për shpallje.

Shkolla shtetërore e muzikës – Manastir

### REPUBLIKA E MAQEDONISË KOMUNA E KUMANOVËS

Sektori për urbanizëm, veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës

UP1 21-42/2016  
25.01.2018

Në bazë të nenit 35 paragrafi 3 të Ligjit për Ligjin për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), nenit 50 paragrafi 1 pika 4 e Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 5/02) dhe nenit 25 paragrafi 1 pika 7 e Statutit të Komunës së Kumanovës ("Fletorja zyrtare e Komunës së Kumanovës" nr. 13/03, 13/07 dhe 8/15), Kryetari i Komunës së Kumanovës në vijim jep këtë kumtesë:

#### KUMTESË

- Për organizim të Anketës së serishme publike dhe Prezantimit publik në lidhje me
- Propozim – Planin e detajuar urbanistik për pjesën nga U. E "Goce Dellçev" pjesë nga Blloku urban 27, përfshirja planore mes rrugës rajonale Kumanovë – Sv. Nikole rr. "2001" rr. "AVNOJ" dhe rr. "Vidoe Smilevski – Bato" – Komuna e Kumanovës, përfshirje planore me sipërfaqe prej 17,48 ha.
  - Propozim - Plani i detajuar urbanistik për pjesën nga U. E "Pero Çiço" pjesë nga Blloku urban 15, përfshirja planore mes rr. "Mihaillo Pupin" dhe krahut të rr. "Mihaillo Pupin" – Komuna e Kumanovës, përfshirje planore me sipërfaqe prej 0,88 ha.

Anketa e serishme publike dhe Prezantimi publik në lidhje me Propozim PDU-ve do të realizohet me prezantimin e Propozim PDU-ve në Sirtarët e komunës në Sheshin e qytetit, që gjenden tek ish "Tutun" – Kumanovë. Anketa e serishme publike do të zgjasë 5 ditë pune duke filluar prej më 01.02.2018 deri më 07.02.2018. Gjatë kohës së anketës publike subjektet e interesuara fizike dhe juridike informata më të detajuara mund të marrin në Komunën e Kumanovës, Sektori për urbanizëm dhe veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës. Gjatë anketës publike propozimet dhe vërejtjet mund të dorëzojnë të gjithë subjektet e interesuara fizike dhe juridike në listat anketuese.

#### PREZANTIMI PUBLIK


Më datë 05.02.2018 në ora 12<sup>00</sup>, në sallën e mbledhjeve në Komunën e Kumanovës organizohet Prezantim publik me prezantim profesional të

- Propozim – Planin e detajuar urbanistik për pjesën nga U. E "Goce Dellçev" pjesë nga Blloku urban 27, përfshirja planore mes rrugës rajonale Kumanovë – Sv. Nikole rr. "2001" rr. "AVNOJ" dhe rr. "Vidoe Smilevski – Bato" – Komuna e Kumanovës, përfshirje planore me sipërfaqe prej 17,48 ha.
- Propozim - Plani i detajuar urbanistik për pjesën nga U. E "Pero Çiço" pjesë nga Blloku urban 15, përfshirja planore mes rr. "Mihaillo Pupin" dhe krahut të rr. "Mihaillo Pupin" – Komuna e Kumanovës, përfshirje planore me sipërfaqe prej 0,88 ha.

Kryetari i Komunës  
Maksim Dimitrevski



Nga të dhënat e sondazhit, në të cilin një e pesta është e papërcaktuar, rezultoi se për një referendum të dytë janë shprehur 58 për qind e të anketuarve, ndërkohë që kundër kësaj nisme janë shprehur 42 për qind.



## VETËM NJË REFERENDUM I DYTË SHPËTON BRITANIKËT

Votuesit në Britani të Madhe mbështesin idenë për mbajtjen e një referendumi të dytë lidhur me statusin e tyre në Bashkimin Evropian (BE), flasin të dhënat e një sondazhi të zbatuar në janar të këtij viti. Sondazhi i kryer nga agjencia ICM në kuadër të projektit Guardian Reporting, ka nxjerrë në pah të dhënat se 47 për qind e të anketuarve favorizojnë të votojnë marrëveshjen përfundimtare sapa të bëhet të ditura kushtet e largimit të Britanisë nga BE-ja, ndërkohë që 34 për qind, kundërshtojnë një ide të tillë. Nga të dhënat e sondazhit, në të cilin një e pesta është e papërcaktuar, rezultoi se për një referendum të dytë janë shprehur 58 për qind e të anketuarve, ndërkohë që kundër kësaj nisme janë shprehur 42 për qind.

Ndonëse opinioni publik mbetet i ndarë sa i përket kësaj çështjeje, ajo që befason është se një e katërta e votuesve të cilët kanë dhënë votën për largim nga BE-ja, tashmë preferojnë një tjetër referendum mbi këtë çështje. Ashtu siç zbulon rritjen e interesit për një referendum të dytë, gjetjet e tjera kyçe të sondazhit flasin edhe për një shqetësim në rritje për

ndikimin e mundshëm që do të ketë Brexiti, pasi 43 për qind e votuesve të tij, tashmë kanë thënë se janë të brengosur se Brexit do të ndikojë negativisht mbi ekonominë e Britanisë së Madhe, ndërkohë që një shumicë e të anketuarve kanë thënë se Brexit do të ndikojë negativisht në "mënyrën britanike të jetës". Karakteristikë e këtij votimi është edhe hendeku demografik, pasi është shtuar numri i të rinjve të cilët do të votojnë për mbetje në

BE, dhe në të njëjtën kohë personat e moshës mbi 65 vjeçare, kanë shprehur bindjet e tyre për votën për largim.

Sondazhi i zbatuar në rajone të ndryshme të Britanisë së Madhe, zbuloi se votuesit në Skoci dhe në Irlandën e Veriut akoma më shumë kanë përforcuar bindjen për të votuar për qëndrim në BE, ndërkohë që votuesit në pjesën më të madhe të Anglisë dhe Uellsit përkrahin bindshëm largimin. Ashtu siç po bëhet e

qartë dobësia e qeverisë për të negociuar, gjithnjë e më shumë po bëhet e qartë mbështetja për një votim tjetër Brexit, madje edhe në zonat ku nuk është paramenduar. Ish-lideri i UKIP-it, njëherësh aktivist i devotshëm i kampit për largim të Britanisë nga BE-ja, Nigel Farage, në fillim të muajit tha se "ndoshta, them vetëm ndoshta, po vij në një periudhë kur po mendoj se duhet të kemi një referendum të dytë për anëtarësinë tonë në BE".

### BREXITI GABIM MJAFT I RËNDË

Jo katastrofë, por gabim - ky është gjykimi që jep sot ish-kryeministri britanik Cameron për Brexitin. Gjithsesi, një gabim; kjo në një kohë kur shqetësimi në politikën e brendshme në Britaninë e Madhe është në lidhje me "pranimin", se skenaret e përmbysjes së botës të atyre që kanë ngulur këmbë që Britania e Madhe të qëndronte në BE, nuk u bënë realitet. E vërtetë, nuk ndodhi recesion, nuk ndodhën pushime masive nga puna. Por paundi e ka humbur dukshëm vlerën. Shumë e vështirë, për sa i përket zhvillimit ekonomik, do t'ia dilet mbanë, parashikon

Cameroni. Kush e di. Kur dy vjet më parë ai vendosi të zhvillonte referendumin për Brexitin, për t'a hequr qafe njëherë e përgjithmonë këtë temë për partinë e tij, pasi priste të fitonte kampi i BE, ai bëri gabimin më të madh të jetës së tij. E vlerësoi kryekëput gabim atmosferën në vend. Fushata e tij elektorale vuajti nga mungesa e besueshmërisë: për vite të tëra, Cameroni ishte hequr si euroskeptik - kurse pastaj papritur anëtarësia e Britanisë së Madhe në BE u bë me rëndësi ekzistenciale. Valët e zemërimit së shpejti do të bien.

## Vendim i gjykatës gjermane: Arrat lejohet të bien nga pema!

Gjykata e qarkut në Frankfurt vendosi se arrat lejohen të bien nga pemët, duke konkluduar se ky fenomen vjeshtor që përsëritet çdo vit mund të konsiderohet si "fakt natyror". Vendimi u mor pas një padie që kishte ngritur një grua, makina e së cilës qe dëmtuar nga arrat që binin nga pema e fqinjët të saj. "Paditësja thekson se arrat dhe degët e pemës së arrës kishin rënë mbi makinën e saj për shkak të erërave të forta një natë tetori të vitit 2013 dhe kishin shkaktuar dëme tek makina", thuhet në vendim. Gruaja e kishte paditur fqinjin e saj për një shumë prej 3866.36 eurosh për të mbuluar shpenzimet për riparimin e makinës së bashku me interesin



bankar të shumë. Degët e pemës së fqinjës kishin kaluar me 1.5 metra në pronën e paditëses për shkak të një "gabimi statistikor". Fqinji, pra i pandehuri, i kishte prerë rregullisht degët dhe pema qe e shëndetshme. Po ashtu fqinji e kishte refuzuar më parë kërke-

sën me shkrim të gruas që i kërkonte leje për të ndërtuar një strehë me çati për automjetin e saj. I pandehuri kishte argumentuar se ai nuk ishte përgjegjës për pagimin e dëmeve pasi rënia e arrave nga pemët në vjeshtë është "një proces i natyreshëm dhe bën

pjesë në rreziqet natyrore të jetës". Në vendimin e saj (27.01.2018) gjykata mori anën e të paditurit duke arritur në konkluzionin se "paditësja duhet të llogarisë me rënieën e arrave nga një pemë arre gjatë vjeshtës". "Për të përjashtuar plotësisht rrezikun që vjen nga arrat që bien, i vetmi përfundim logjik është ose prerja e pemës në fjalë ose e rrethimit me një rrjetë sigurie". Megjithatë një opsion i tillë do të ishte i paarsyeshëm për shkak të shpenzimeve që nevojiten dhe faktit që bashkia do ta kundërshtonte një gjë të tillë. Paditësja duhet të mbajë shpenzimet gjyqësore. Ajo mund të paraqesë ankesë në gjykatën e apelit brenda një muaji.

## Në një sulm kibernetik vidhen mbi 500 milionë dollarë

Hakerët vodhën 534 milionë dollarë nga shkëmbimi valutor digjital japonez Coincheck, njoftojnë mediat lokale. Në deklaratën e Coincheck thuhet se hackerët kanë thyer fjalëkalimet të premtën në ora 02:57 sipas kohës lokale. Kripto-valutat u dërguan nga adresa NEM e Coincheck. NEM është një kriptovalutë e ndërtuar në sistemin e ngjashëm si Bitcoin. Agjencia japoneze e lajmeve Kyodo njoftoi se Presidenti i Coincheck, Koichiro Wada gjatë një konference për media të premtën vonë tha se kompania mund të kërkojë ndihmë financiare. Kompania me qendër në Tokio bllokoi transaksionet për të gjitha valutat e krijuara pas sulmit kibernetik, përveç Bitcoin. "Blerjet dhe shitjet e kripto-valutë, përveç BTC (altcoins) momentalisht janë të kufizuara. Ju lutem pranoni falje për këtë shqetësim", thuhet në faqen zyrtare të Coincheck. Pas vjedhjes, vlera e përgjithshme e shkëmbimit të kripto-valutës u zvogëlua me rreth 10 për qind ndërkohë që pati një humbje prej gjashtë trilionë jen japonez (55.3 miliardë dollarë). Kjo mund të jetë vjedhja më e madhe e kripto-valutës.



## Sulmi me bombë në Afganistan, 95 të vdekur

Numri i të vdekurve në sulmin me autobombë në kryeqytetin e Afganistanit, Kabul, është rritur në 95. Zyrtarët e sigurisë konfirmuan se sulmi ka ndodhur në afërsi të ish-ndërtesës së Ministrisë së Brendshme dhe Spitalit. Ministria e Shëndetësisë njoftoi se numri i viktimave në sulm është rritur në të paktën 95 persona, ndërsa janë plagosur 158 të tjerë. Ministria gjithashtu njoftoi se një numër i madh i të vdekurve janë civilë. Ndihmës zëdhënësi i Ministrisë së Brendshme, Nasrat Rahimi, kishte thënë se sulmuesi që të arrinte në rajon bombat i ka vendosur në ambulancë. Në këtë rajon ku bëhen kontrole të nivelit të lartë të sigurisë gjenden edhe përfaqësitë diplomatike të shumë vendeve. Presidenti i Afganistanit, Eshref Gani, dënoi sulmin. Përgjegjësinë mbi sulmin e kishte marrë organizata terroriste e talebanëve.



# BOTOHEN VARGJET E PANJOHURA TË KADARESË

Vepra poetike e Ismail Kadaresë përmbledhet në një vëllim të vetëm, ku do të gjenden poezitë e krijuara mes viteve 1957-2005. Botuesi i tij, Bujar Hudhri, bën me dije për "Gazeta Shqiptare", se ditën e hënë botimi do të jetë në çdo librari, duke vënë tashmë në një libërlidhje të vetme, më të mirën e vargjeve kadareane të pesë dekadave. Lajmi bëhet publik me rastin e datëlindjen së tij të 82-të, që e kishte djë



thoshte se kësaj bote, botës Lindore, i shkonin për shtat më shumë poezitë, sesa proza. Një novelë e hershme e tij, 'Ditë kafenesh', sa u botua, u kritikua e u ndalua. Më vonë iu ndalua romani 'Përbindëshi'. Ka pasur romane të tijat që janë botuar dhjetë apo njëzet vjet më pas nga ç'i kishte shkruar. Ndonjëri është botuar edhe dyzet vjet më pas nga koha kur u shkrua 'Qyteti pa reklama', shënon Bejko në parathënie. Shton mandej se fill pas mbarimit të studimeve, vjen romani "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", (1963), i cili që me botimin e parë në Paris, u shpall libër botëror. Si duket, ajo bota tjetër, Perëndimi, pëlqente më shumë prozën e tij. Sadik Bejko e nis me një varg shënimitin e tij: Pa formë është qielli, si tru idioti, një varg i shkëputur nga poezia "Vjeshtë tiranase", botuar më 1957, në gazetën "Zëri i rinisë". Vargu Pa formë është qielli, si tru idioti na çon në fillimet e krijimtarisë së autorit. Të shkruaje kështu atëherë ishte e pazakonshme. Bejko vëren se shumë prej poezive të Ismail Kadaresë kanë qenë bërthama të veprave të tij të ardhshme në prozë. Poema "Rrugëve të Moskës" do ta çojë te romani "Muzgu i perëndive të stepës", poezia "Piramida e Keopsit" do të sillte më pas romanin "Piramida", poezia "Kali i Trojës" paralajmëron romanin "Përbindëshi". Por tek ai ka ndodhur edhe procesi i kundërt. Meqë ky roman nuk u botua, ndalimi i tij lind vjershën e gjatë "Laokoonti", një nga krijimet më të rëndësishme të tij. Kthjelltësia e derdhur në një gjuhë fare të lirshme, pa asnjë sforcim, vërehet që te lirikën e librit Endërrimet, por edhe te poezitë e viteve të

studimeve në Moskë, prej së cilave po përmendim edhe kur kujtesa, Kthimi në Moskë, Llorë, etj.

Kjo mjeshtëri e tejdukshmërisë gjuhësore vërehet edhe te pamjet e natyrës në Tiranë, ku vjeshta si luanëshë krifëverdhë ruan ditët e fundit nga dimri, te poezia Mall, që është bërë aq popullore edhe në ditët e sotme, mbase për atë tjetërsim të qelqtë, por prapë tjetërsim, të njeriut nga njeriu në një mjedis kryeqytetas. Muret janë të qelqta, por sot njeriu dhe natyra rreth tij, njeriu dhe e natyrshmjia si përvojë, si komunikim, janë ngjethshëm e rreptësisht larg njëri-tjetrit, janë të papërputhshëm fizikisht e shpirtërisht. Ajo që mbetet për t'u thënë e për t'u rithënë është habia se si erdhën në liri këto poezi të kohës së diktaturës. Pse ato ende janë po aq të freskëta sa dhe pesëdhjetë vjet më parë, në kohët kur u shkruan? "Kadareja ka një novelë të titulluar Kalorësi me skifter. Paradigma e kalorësit të ftuar në një festë është domethënëse për ata shkrimtarë të ftuar nga komunizmi për të qenë kalorës të sofrës së artit të tij. Kalorësi i zymtë hynte në darkën e të ftuarve me një mëdyshje mepërmes: ishte kurth apo ishte vlerësim për të kjo ftesë? Sigurisht që ishte kurth, kurthi i vdekjes së tij si autor. Në këtë festë, kalorësin e kishin thirrur vetëm që ta asgjësonin. Në poezi, ftesa për të kaluar nëpër kurthe të tilla ka qenë më vdekjeprurësja", thotë Bejko. Ai shton se shumë shkrimtarë që i besuan kokë e këmbë kësaj feste, vdiqën bashkë me komunizmin. Në rastin më të mirë, prej tyre kanë ardhur në ditët tona pjesë a pjesëza të një krijimtarie pa shpirt.

## KADARESË I DORËZOHET ÇMIMI 'NONINO'

Shkrimtarit shqiptar me përmasa botërore Ismail Kadare dje i është dorëzuar Çmimi "Nonino" për letërsi për vitin 2018, në ceremoninë solemne në distilleritë "Nonino", në Percoto të Udineses, në Itali. "Rapsod në dashuri dhe kritik ndaj popullit të tij, midis realiteteve historike dhe legjendave, të cilat ngjallin madhështinë dhe tragjedinë e së kaluarës ballkanike dhe osmane", thuhet në arsyetimin e jurisë së çmimit. Ky çmim

jepet që nga viti 1977 për autorët që nxjerrin në pah vlerat e qytetërit. Laureat i Çmimit "Nonino" për eseistikë për vitin 2018 iu dha filozofit të shquar italian, Giorgio Agamben, i cili konsiderohet si njëri ndër më të rëndësishmit në botë sot. Ambasadorja e Kosovës në Itali, Alma Lama, ka postuar në profilin e saj në Facebook disa fotografi nga ceremonia solemne e dorëzimit të çmimeve.

## BOTIME



SAMUEL P. HUNTINGTON

## PËRPLASJA E QYTETËRIMEVE

Kur në vitin 1998 pa dritën kjo vepër mjaftë ambicioze, Francis Fukojama, një emër me renome botërore në lëmin e shkencave të politike, pati thënë se ky libër është marramendës nga përmasat e shtrirjes dhe rrokja e ndërlikimeve të politikës globale bashkëkohore, ndërkaq Zbignjev Bzhezinski, politikolog i shquar dhe këshilltar i ish kryetarit amerikan, Xhimi Karter, ishte shprehur se bëhet fjalë për një kryevepër intelektuale: e guximshme, me forcë imagjinatë dhe provokuese. Një punë themelvënëse, që do ta revolucionojë të kuptuarit e punëve ndërkombëtare nga ana jonë. Samuel P. Huntington në veprën e tij kapitale "Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rëndit botëror" trajton këto tema: nocioni i qytetërimeve; çështja e një qytetërimi universal; marrëdhënia ndërmjet fuqisë dhe kulturës; zhvendosja e peshores së fuqisë ndërmjet qytetërimeve; indigenizimi kulturor në shoqëritë joperëndimore; struktura politike e qytetërimeve; konfliktet e përfuara nga universalizmi Perëndimor, militantizmi mysliman dhe ngulmimi kinez; baraspeshimi dhe nxjerrja në krye e përgjigjeve ndaj ngritjes së fuqisë kineze; shkaqet e dinamika e luftërave në vijën e shkëputjes si dhe e ardhmja e Perëndimit dhe e një botë qytetërimesh. Ky libër që ka shënuar suksese të jashtëzakonshme gjithandë ku është përkthyer, është i rëndësishëm edhe për lexuesin shqiptar, sidomos për studentët që i studiojnë marrëdhëniet ndërkombëtare, për politikanët, për analistët, për historianët, aq më tepër nëse kihet parasysh fakti se kjo vepër ka për qëllim interpretimin e evoluimit të politikës globale pas Luftës së Ftohtë, përkatësisht se synon të paraqesë një kornizë, një paradigme për të vështruar politikën globale në mënyrë që të jetë kuptimplotë për studiuesit dhe e dobishme për hartuesit e politikës. Vepra "Përplasja e qytetërimeve" vjen e përkthyer (nga gjuha angleze) shkëlqyeshëm nga profesor Xhevat Lloshi, ndërkaq vazhdon të mbetet si një nga projektet me cilësore të Shtëpisë botuese "Logos A", edhe pas ribotimit të tretë.

BOTIME



GJURO SHUSHNJIQ

## PESHKATARËT E SHPIRTRAVE NJERËZORË

Të kesh si bosht të veprës idenë e manipulimit dhe manipulimin e ideve, do të thotë të depërtosh në një sistem ku, pavarësisht se liria duket e plotë, megjithatë, në fakt ky depërtim nxjerr në pah segmentet e totalitarizmit të maskuar. "Peshkatarët e shpirtave njerëzorë" nga Gjuro Shushnjq, është një vepër që mëton ta kërkojë të vërtetën. Në këtë libër brilant trajtohet çështja se si udhëhiqen dhe si mashtrohen njerëzit dhe popujt, pa qenë të vetëdijshëm për këtë. Ky është një rrëfim për prijësit, pas të cilëve nuk mbetet asnjë gjurmë gjaku, por jo më pak të rrezikshëm, sepse ata nuk vrasin trupin, por lëndojnë shpirtin. Autori thotë se njerëzit nuk janë të vetëdijshëm, ose nuk janë aq sa duhet të vetëdijshëm se jetën e tyre të përditshme e mbikëqyrin grupet e fuqishme, që përmes mediave masive lëshojnë shiun e simboleve të organizuara dhe të përzgjedhura me kujdes, funksioni i të cilave nuk është që të informojnë botën, por të shfrytëzojnë nevojën e botës.

Qëllimi kryesor i këtij "radioaktiviteti shpirtëror" përbëhet prej "kurdisjes së shpirtave njerëzor, ndërkaq pasoja kryesore është zhvendosja e vullnetit të tyre për vetëvendosje. Në hapësirat ballkanike padyshim se populli më i manipuluar nga të vetët, është populli shqiptar. Ndaj, lexuesi shqiptar, duke e pasur para vetes këtë libër, nuk do ta ketë fare vështirë ta kuptojë të vërtetën e manipulimit të shqiptarëve nga prijësit e tyre. Libri në fjalë vjen në botim të Shtëpisë botuese "Logos A" (2017).

# KOLEKSIONISTI I 100 ARTEFAKTEVE PËR SKËNDERBEUN E HISTORINË SHQIPTARE



Eksplorimi i së kaluarës e ka intriguar çdoherë Ilir Xheladini, i cili tashmë veçse njihet si një prej koleksionistëve më të përkushtuar të artefakteve që lidhen me historinë shqiptare. Pikë të dobët e ka heroin kombëtar Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, për të cilin ka hulumtuar nëpër arkiva të institucioneve të ndryshme në gjithë botën. Në një bisedë për "Kohën Ditore", Xheladini i cili jeton në Zvicër rrëfen sesi ka zënë fill koleksioni i tij që tashmë numëron mbi 100 artefakte të ndryshme. Po aq të ndryshme sa edhe vendet ku i ka gjetur, datat e rrëfimit që bartin më vete.

Më 17 janar, ai u kthye në Prishtinë për ta realizuar një ekspozitë që iu dedikua përvjetorit të 550-të të vdekjes së Skënderbeut. Me këtë udhë, e dha edhe një lajm të rëndësishëm.

Koleksionuesi e ka ndërmend që ta themelojë një muze, në të cilin do të ruhet kjo pjesë e rëndësishme e historisë shqiptare "Zanafilla e koleksionit është qëkur isha student, si nevojë e njohjes së historisë sonë e sidomos afirmimit të



Xheladini i cili jeton në Zvicër rrëfen sesi ka zënë fill koleksioni i tij që tashmë numëron mbi 100 artefakte të ndryshme. Po aq të ndryshme sa edhe vendet ku i ka gjetur, datat e rrëfimit që bartin më vete



saj. E para gjë që kam blerë është një 'Atlas' që daton nga viti 1873, aty flet për ilirët, për mbretin Gent,

harta të ndryshme ku përshkruhen trojet ilire", ka rrëfyer Xheladini.

(koha.net)

## Rita Ora më 17 shkurt këndon në Kosovë



Autoritetet kosovare thonë se Rita Ora ka konfirmuar se më 17 shkurt vjen në Kosovë. Këngëtarja Rita Ora do të performojë në Kosovë me rastin e 10 vjetorit të Pa-

varësisë. Edhe pse ditë më parë u shkrua se Rita do të performojë për Pavarësi, ende pati dilema, pasi që menaxhmenti i Ritës në vendin ku i publikojnë datat e koncerteve nuk

pati edhe koncert për në Kosovë. Por se Rita do të performojë më 17 shkurt është konfirmuar edhe një herë. Këtë e ka bërë të ditur Petrit Selimi në Twitter. "Populli kosovaro-britanik, Rita Ora, ka konfirmuar koncertin e madh për 10 vjetorin e pavarësisë së Republikës. Njerëz, vetëm kujtoni se Roma nuk është ndërtuar për një ditë. Por, sigurisht se ata kanë pasur festa të mira", ka shkruar ai në Twitter. Rita Ora ka prezantuar Kosovën mjaft mirë në botë përmes sukseseve të saj të shumta, me ç'rast në Kosovë ka realizuar edhe videoklipin e këngës "Shine Ya Light", e cila pati sukses të madh.

BOTIME



MILAZIM KRASNIQI

## NACIONALIZMI SHQIPTAR

Me etiketën "nacionalist" dhe "nacionalizëm shqiptar" si argument suprem, që nuk kishte nevojë as për dëshmi e as për dëshmitarë, në vitin 1981-1999, janë burgosur e janë dënuar me mijëra shqiptarë. Me kualifikimin denoncues e zhvlerësues, si dukuri nacionaliste, janë përfshirë edhe këngë popullore, poezi, tregime, romane, fjalëkryqë, karikatura, dasma, me një fjalë e tërë jeta e shqiptarëve të Kosovës dhe e shqiptarëve të mbetur në Jugosllavi.

Duke e lënë mënjanë të kaluarën dhe manipulimin që është bërë me nacionalizmin shqiptar e duke e shikuar gjendjen e sotme, Krasniqi shtron disa pyetje logjike: pse as në Kosovë e as në Shqipëri nuk është hapur ende debat për këto deformime të rënda që i janë bërë identitetit nacional shqiptar, së pari në kuptimin më të gjerë e veçmas nacionalizmit shqiptar? Pse nuk u dënuan deri sot krimet e komunizmit dhe ekzekutorët e atyre krimeve kundër nacionalistëve shqiptarë?

Pse ende nacionalizmi shqiptar nuk është rivalizuar në dimensionin e vërtetë teorik dhe në realitetet e reja shqiptare? Por, autori nuk merr përsipër të japë këto përgjigje, por mëton të hapë diskutim lidhur me nacionalizmin shqiptar, duke provuar të kuptojë edhe se a mund të rigjenerohet ai dhe a mund të bëhet gjenerator i zhvillimit i kombit dhe shtetit apo shteteve shqiptare. Vepra "Nacionalizmi shqiptar" i Milazim Krasniqit është një nga veprat më të rëndësishme që ka të bëjë me çështjen shqiptare, e cila vazhdon të përballet me sfida të deformimit jo vetëm të nacionalizmit, por edhe identitetit. Botoi "Logos A" (2017)

# NUDOJA QË VLEN MILIONA EURO

Edhe pse ndërroi jetë në moshën 35-vjeçare, ai arriti të krijonte disa punë jashtëzakonisht të dëshirueshme siç është edhe kjo pikturë. Realizuar në vitin 1919, me një stil mjaft unik, doli në ankand në vitin 1999 dhe u ble për 16.770.000 dollarë

Ajo ka një gëzim të fshehur, nën buzët që shkëlqejnë nga buzëkuqi, ndërsa me krah përpjetet të mbulojë gjoksin. Nuk ka asnjë të përbashkët me gruan e artistit të njohur italian Jeanne, por mendohet se mund të ketë qenë jo thjesht një modele, por një histori dashurie e tij. Ndryshe kjo nudo nuk do të mund të mbarte ndër vite atë fuqinë e jashtëzakonshme që depërton tek ty pas çdo shikimi. Piktura titullohet "Romania e bukur", duke mbartur sekretin e një historie që fshihet pas saj. Amedeo Modigliani, një artist italian me origjinë hebreje, pati një jetë jo të zakonshme.


Edhe pse ndërroi jetë në moshën 35-vjeçare, ai arriti të krijonte disa punë jashtëzakonisht të dëshirueshme siç është edhe kjo pikturë. Realizuar në vitin 1919, me një stil mjaft unik, doli në ankand në vitin 1999 dhe u ble për 16.770.000

dollarë. Modigliani ishte burrë i pasur dhe tërhiqte shumë vëmendje nga gratë e asaj kohe. Por një nga lidhjet e tij më të njohura është ajo me bashkëshorten Jeanne e cila ishte ndryshe nga aventurat e tjera. Të dy u dashuruan në njëri tjetrin deri në marrëzi. Përkundër kundërshtimit të prindërve të saj, Jeanne, vajzë me guxim të tepruar në atë kohë, vendosi të jetonte me Modiglianin. Jeta me Modiglianin nuk ishte aspak e lehtë për Jeanne. Ai abuzonte me alkool dhe drogë. Konsumimi i madh i alkoolit dhe drogës mund të jenë shkaktari kryesor për sëmundjen e tij me tuberkuloz. Jeanne nga historianët e artit përshkruhet si një vajzë e bukur dhe si karakteristike e saj ishin flokët e gjata dhe të plotë. Në komunitetin artistik në Montparnasse, ajo u prezentua nga vëllai i saj André Hébuterne, i cili dëshi-



**Jeanne Hébuterne u kthye në shtëpinë e familjes së saj, por e dërrmuar nga dëshpërimi për humbjen e njeriut që kishte dashur me shpirt, një ditë pas vdekjes së Modiglianit, ajo edhe pse shtatzënë - kreu vetëvrasje duke u hedhur nga kati i pestë**

ronte të bëhej piktor. Albert Cingria e ka përshkruar Jeanne si vajzë të butë, të turpshme, të qetë dhe delikate. Në vjeshtën e vitit 1918, çifti u shpërngul në klimën më të ngrohtë të Nisës në Rivierën Franceze ku agjenti i Modigliani shpreonte që ai të mund të rriste profilin e tij duke shitur disa nga veprat



e tij tek njohësit e pasur të artit. Gjatë kohës që ata jetuan në Nisë, lindi vajza e tyre e parë. Pas një kohe, ata u kthyen në Paris dhe Jeanne ngeli përsëri me barrë.

Me 24 janar 1920 Amedeo Modigliani vdiq nga tuberkulozi. Jeanne Hébuterne u kthye në shtëpinë e familjes së saj, por e dërrmuar nga dëshpërimi për humbjen e njeriut që kishte dashur me shpirt, një ditë pas vdekjes së Modiglianit,

ajo edhe pse shtatzënë - kreu vetëvrasje duke u hedhur nga kati i pestë. Familja e saj nuk dëshironte që ajo të prehej në të njëjta varreza ku prehej edhe trupi i Modiglianit. Dhjetë vite më vonë familja u zbut dhe lejoj që eshtrat e saj të transferoheshin në varrezat Père Lachaise për të pushuar pranë Modigliani. Në epitafin e saj shkruhet: "Shoqëruese e devotshme deri në sakrificën ekstreme."

## KAZABLANKA, 75 vjet nga lindja e një klasiku të pavdekshëm

Edhe pas 75 vitesh ka nga ata që se kuptojnë se pse Rick-u hoqi dorë nga dashuria e tij. Thuhet se xhirimet nisën pa e ditur fundin, pa e ditur nëse do të ishte Rick apo Victor Laszlo ai që do të mbetej me Ilsen. Kronikat e kohës tregojnë që xhirimet e këtij filmi ishin shumë kaotike



23 janar 1943. Pra këtë vit mbushen treçerek shekulli që nga i paharueshmi film i Michael Curtiz: "Një ditë do ta kuptosh. Hajde, hajde, ...shko me të Ilsa!" thotë Bogarti në lamtumirën e tij me Bergmanin që e detyron të hipë në një avion bashkë me bashkëshortin e saj, Victor Laszlon (Paul Henreid). Edhe pas 75 vitesh ka nga ata që se kuptojnë

se pse Rick-u hoqi dorë nga dashuria e tij. Thuhet se xhirimet nisën pa e ditur fundin, pa e ditur nëse do të ishte Rick apo Victor Laszlo ai që do të mbetej me Ilsen. Kronikat e kohës tregojnë që xhirimet e këtij filmi ishin shumë kaotike. Protagonisti ishte shumë i shkurtër për xhirimin e disa skenave, pianisti Sam i luajtur nga Dooley Wilson

nuk dinte të luante në piano. Asnjë nga producentët dhe skenaristët, aktorët madje as edhe vetë regjisori që xhiruan Kazablankën në studiot e Warner Bros, nga të cilat vetëm skena e aeroportit u xhirua jashtë, mendonin se do të fitonin 3 çmime Oskar nga Akademia: filmi më i mirë, regjisori më i mirë dhe skenari më i mirë. Rick ishte personazhi romantik në kuptimin e ngushtë të fjalës për Humphrey Bogartin, zgjedhja e të cilit në këtë rol ishte polemizuese sepse thuhet në fillim e kishte refuzuar Ronald Reagani. Me kalimin e kohës Reagani do të shndërrohej në presidentin e Amerikës dhe Bogarti në legjendë.

Me rastin e 70 vjetorit u bë e ditur se Warner Bros kishte hapur dritën jeshile për xhirimin e një serie të dytë të shkruar nga Howard Koch, një nga tre skenaristët bashkë me Julius J. Epstein dhe Philip C. Epstein dhe që e kishte braktisur idenë prej dekadash. Sipas këtij skenari që mbante një titull "Kthim në Kazablanka" me largimin nga

Kazablanka, Ilsa e kupton se është shtatzënë dhe lind një djalë që do të rritet në tokat amerikane. Ilsa i rrëfen Laszlos që fëmija nuk është i tij, por i Rick-ut, diçka që i shoqi e pranon dhe vendos ta rrisë sikur të ishte i tij. Kur fëmija i quajtur Richard, rritet e bëhet një djalë i bukur dhe me zemër të madhe, mëson të vërtetën dhe kërkon të njohë të atin apo të dijë pak më shumë për të meqë pjesëmarrja në rezistencë e kishin shndërruar Rick-un në një legjendë në Kazablankë. Sipas Koch, i cili vdiq në vitin 1995, ngjarjet e filmit do të vendoseshin në vitin 1961 kur njëzet vjeçari Richard do të mbërrinte në Kazablankë pas vdekjes së të ëmës dhe të Laszlos për të ditur më shumë për babain e tij të vërtetë. Një histori që Cass Warner është përpjekur disa herë për ta realizuar, por pa sukses. Me rastin e 75 vjetorit të shfaqjes, të shohim pasi studioja e ka një projekt që ka vite që endet në ujëra të ndenjura, ndërkohë për ne... "Gjithmonë do të na mbetet Parisi!"

Mendo  
SIGURI  
PA KUFI.

Mendo



+389 2 3288 800  
[www.uniqa.mk](http://www.uniqa.mk)

SIGURIME  
JETË dhe JO-JETË



**DASHI** 21. mars - 20. prill

Do e vlerësoni mjaft ndihmën që do iu japë partneri juaj sot dhe do kaloni një ditë interesante pranë tij. Bashkëpunimi dhe mirëkuptimi nuk do ndalet në asnjë moment. Beqaret do mbyllen në vetvete dhe nuk do përfitojnë aspak nga ftesat që do iu bëhen. Financat do jene të paqëndrueshme, por me pak durim dhe maturi mund t'ia dilni mbanë ta stabilizoni situatën.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Do jeni shume kërkues në dashuri sot dhe nuk do kënaqeni me pak. Partneri do mundohet shume që ju të ndiheni sa me mire, por ndonjëherë jo çdo gjë është aq e lehtë sa duket. Për beqaret nuk priten ndryshime të mëdha. Do jete një ditë e qete dhe pa gjera të jashtëzakonshme. Maturitë dhe sa me shume maturi duhet të tregoni me financat.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Pasioni do jete shume i zjarrte gjate kësaj dite në jetën tuaj në çift. Pas një periudhe të mbushur me peripeci dhe brenga, me ne fund do përjetoni emocionet e shumëpritura. Beqaret duhet të tregojnë veten si janë me personat që do takojnë dhe jo t'i gënjejnë ata për gjithçka. Nuk keni për të shkuar asgjëkund kështu. Në planin financiar duhet të tregoheni të kujdesshëm.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Dita do filloje me tension dhe debate të shumta për jetën në çift, por me kalimin e orëve do i mendoni gjerat me kujdes dhe do gjeni zgjidhje për çdo problem. Beqaret do përballen me surpriza mjaft të këndshme të cilat janë menduar me kujdes nga miqtë e ngushtë. Financat nuk do jene në gjendjen me të mire kështu që kujdes me çdo shpenzim që do kryeni.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Priten përmirësime të shumta gjate kësaj dite në jetën tuaj sentimentale. Te dy me partnerin do tregoheni me të hapur dhe do provoni eksperiencat e reja se bashku. Beqaret do jene shume të sinqerte me disa persona që do i joshin në mënyrë që edhe ata të mos lëndohen. Perspektivat financiare do jene të mrekullueshme. Përfitoni për të bere ndonjë investim.



**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Ata që janë në një lidhje do e kenë të vështirë të flasin për çdo gjë me partnerin e tyre sot sepse ai do jete me humor të keq. Priten orët e pasdites sa të qetësohet. Beqaret duhet të bëjnë akoma edhe me shume durim nëse duan të takojnë personin që do iu përshatet me se miri. Në planin financiar do jete dite me fat. Do kryeni transaksione dhe do hiqni disa para mënjani.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Surprizat në çift do jene të njëpasnjëshme gjate kësaj dite. Partneri do kujdeset mjaft për ju dhe nuk do iu lere të lodheshi për asgjë. Sot ju do jeni si një princeshe e përkëdhelur. Beqaret do kenë mjaft takime interesante, por do e kenë të vështirë të fillojnë menjëherë një lidhje. Në planin financiar duhet t'i mbani këmbët në tokë dhe të mos bëni shpenzime marramendëse.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Ka shume gjasa që për shkak të mungesës së përkujdesjes nga partneri ju ta kërkonin diku tjetër ngrohtësinë. Mendohuni mire sepse me vone mund të plase një skandal i madh për ju. Beqaret do ndihen të kënaqur me jetën që po bëjnë dhe nuk do kenë aspak nevojë ta ndryshojnë atë. Sektori i financave nuk do kërcënohet aspak. Situata pritet të jete e qëndrueshme.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Klima në jetën tuaj në çift do jete mjaft e ngrohte dhe komunikimi nuk do reshte për asnjë moment. Përfitoni për të folur edhe mbi të ardhmen për t'i kuptuar me mire synimet e partnerit. Beqaret do i shprehin pa drujtje pëlqimet dhe shume shpejt mund të fillojnë histori dashurie pasionante. Financat do i menaxhoni me kujdes dhe nuk pritet as problemi me i vogël.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Nëse keni një lidhje prej shume kohesh duhet të bëni shume kujdes me impulsivitetin e tepruar. Në rast tensioni të madh, largohuni nga njeri-tjetri në mënyrë që të mos thoni fjalët e fundit. Beqaret do jene sharmante dhe do marrin shume propozime. Në planin financiar çdo gjë do shkoje me mire se kohet e fundit. Do e dini sa të shpenzoni dhe sa të mbani në xhep.



**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Çiftet do kalojnë një ditë mjaft delikate sot. Mosmarrëveshjet në çift do jene të shumta dhe nga kokëfortësia e të dyve ato do duken të pafundme. Beqaret do gjenden përballë një zgjedhjeje të vështirë. Do jene dy personat që do i joshin pa fund dhe të dy kane cilësi për t'u adhruar. Perspektivat materiale do jene të mrekullueshme. Do jeni të qete në këtë sektor.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Ata që janë tashme në një lidhje do bëjnë çmos që ta përforcojnë edhe më tepër bashkëpunimin. Planetët do i kenë në krah kështu që duhet ta shfrytëzojnë këtë mundësi. Beqaret do jene shume krenare për veten dhe nuk do pranojnë çdo lloj ngacmimi. Te ardhurat nuk do jene të shkëlqyera, por as shume të këqija. Situata do përmirësohet pak nga pak.

## SUDOKU

8								9
		2	9		6	4		
		1	4	7		6		
6			2		3			4
		3				5		
1			6		7			8
		4	5	6		8		
		9	8		2	3		
2								5


**GJASHTË MU AJ PA MË TË DASHURËN TONË**



**PROF. MANUSHAQE KUÇI**  
27.05 1980-29.072017

Sot kur mbushën 6 muaj që kur ike nga kjo botë, ne e kemi të vështirë ta pranojmë realitetin se nuk ndodhesh më në mesin tonë dhe përgjithmonë do të mbesësh në zemrat tona. Thonë se koha I shëron plagët, por sa më shumë që koha po kalon, ne aq më shumë e ndjejmë mungesën tënde.

*Të përkujton bashkëshorti Vullneti me vajzën Oltën nga fshati Sllatinë*



Mensur Mamuti	SERIAL ME AKTORIN NË FOTO	MAKSIMA GREKE, "... EST" (ZARI ESHTE HEDHUR)	QYTETI I LINDJES SË AKTORIT NË FOTO	MAHI E ÇATISË (SH.)	
MARKË RUSE VETURASH					
AKTORI FRENÇ, DELON					
PJESË E TENISIT					
TOKMAK DRURI					
KOMPANI ELEKTRONIKE GJERMANE PRONARI TOKASH NË PER. OSMANE					
A				PARAARDHËSI YNE	
VEPRA, PUNA SERIAL ME AKTORIN NË FOTO					
KOHA	QË ESHTE NË VERI AKTORI AMERIKAN NË FOTO	V	SERIAL ME AKTORIN NË FOTO	PJATA, DAHANI LOCAL STANDARD TIME NATRIUMI	LUKSEMBURGU KRAHINË NË BULGARI, GREQI E TURQI (PASHQ.)
PËRSHËNDËTJE ALLATURKA E NUSES					KALI I SHALES LEGJENDA E FUTBOLLIT PORTUGJEZ
BANORE E ORANIT (EGJIPT)					ROMEN ROLAN KËNGËTARJA TIKARAM
KOMPJUTERË TË VJETËR TË KOMODORES					
A				LLOJ GJELLE (PESHK I MBUSHUR) VOLT	E PASTRUARA ME UJË
FUND (TURQ) LËNG SHERUES				NË TRAJTËN E VEZES PYLLI	
S				LUMË NË SPANJË ISH BOKSIERI AMERIKAN, NORTON	
LITRI	KLUB SPORTIV IZRAELIT RADIUMI				ANGSTREMI EMIL ZOLA
ERBIUMI			FILM ME AKTORIN NË FOTO KALIUMI		
MBULESË ME PRÛSH PËR PJEKJE TË BUKËS, SAÇ					VEND I GJELBERUAR NË SHKRETTETIRE

ZGJIDHJET: LADA, ALEN, SEFI, VARE, EJT, AGAI, AKTI, V, LST, L, TEMENA, ATI, ORANASE, RR, AMIGA, VUTA, SON, VEZAKE, SERUM, GENIL, L, MAKABI, A, ER, LESTER, KAKIN, OAZA.



## Rekord në Dubai, filxhani i çajit më i madh në botë

Dubai e bën sërish! Thyen një tjetër rekord botëror, këtë herë duke krijuar filxhanin më të madh të çajit në botë. Një total prej 120 personash morën pjesë në sfidë. "Filxhani i çajit" është 3.66 metra i lartë, ka një diametër prej 1.42 metrash dhe mund të mbajë një volum prej 5 mijë litrash. Për të mbushur filxhanin u për-

dorën 155 kg çaj, 270 kilogram qumësht pluhur, 360 kg sheqer dhe aromatizues të tjerë si xhinxheri dhe kanella. Pas miksimit me 5 mijë litra ujë në 60 tenxhere, çaji me shijen origjinale ishte gati. Një përfaqësues i Guinness World Record, që ishte i pranishëm në zonë, regjistroi dhe shpalli të vlefshëm rekordin e ri. Më pas,



çaji i nxehtë iu shpërnda vizitorëve të shumtë që dëshmuar arritjen. Shënimi i një rekordi botëror nuk është diçka e re për Dubain, madje kjo është kthyer në një praktikë për të joshur më shumë turistë në qytet. Përveç filxhanit më të madh të çajit, Dubai ka godinën më të lartë dhe ishullin më të madh artificial në botë.

## Djathi i "dehur" që kushton 200 euro



Fabrika "La Caseria Carpenedo" në veri të Trevisos në Itali i zhyt rrotat e djathit në verë. E për këtë arsye djathi i tyre quhet i dehur. Ata bëjnë 15 lloje të ndryshme të djathit të dehur, që mbahet deri në 150 ditë në verëra të ndryshme. Fabrika e djathit filloi prodhimin e djathit të "dehur" në vitin 1976, por origjina e saj daton para Luftës së Parë Botërore. Një rrotë e tërë e këtij djathi kushton deri në 200 euro.

## Ngordh Vila, një nga gorillat më të vjetra të botës




Një nga gorillat më të vjetra në botë ka vdekur në moshën 60 vjeçare. San Diego Zoo Safari Park njoftoi të premten se Vila, e cila ka lindur në Kongo në vitin 1957, vdiq e rrethuar nga pjesëtarët e trupës së saj familjare. Ajo ishte "matriarku", thanë ata, prej pesë gjeneratave. "Ka shumë pak gorila kudo në atë moshë", tha Peggy Sexton, një rojtar i kafshëve në parkun Safari

në Kaliforni. Gorillat zakonisht jetojnë për 35-40 vjet. "Humbjen e saj do ta ndjejnë anëtarët e kopshteve zoologjike, mysafirët, vullnetarët dhe stafi", tha Randy Riches, kuratore e gjitarëve në parkun e safarit. Gorilla më e vjetër që jeton në kujdesin e njerëzve mendohet të jetë Trudy, 61-vjeçar në Little Rock Zoo në Arkansas.

## H&M kërkoi falje për çorapët e fëmijëve me shkrim të ngjashëm si "Allah"

Ndërmarrja ndërkombëtare për veshmbathje me qendër në Suedi, H&M, ka shkaktuar reagime për shkak të figurave të ngjashme me shkrimin "Allah" në gjuhën arabe në çorapët e fëmijëve të cilat i kishte ofruar për shitje. Pasi disa konsumatorë të H&M në këtë vend theksuan se nën çorapët e fëmijëve gjendet një figurë e cila ka kuptimin "Allah" në gjuhën arabe, kompania duke njoftuar se janë keqkuptuar kërkoi falje. Sipas lajmit të televizionit shtetëror suedez, SVT, kompania në një deklaratë ka kërkuar falje për shkak të ngjashmërisë. Kompania njoftoi se i ka mbledhur këto çorape. Ndërkohë, H&M para një kohe kishte kërkuar falje pas reagimeve ndaj publikimi



mit në faqen e saj të internetit të një fotografie të një fëmije model me ngjyrë,

në bluzën e të cilit shkruante "Majmuni më tërheqës në xhungël".



KALENDARI HISTORIK 29 JANAR

- 1613 - Galileu sheh Neptunin por nuk ka mundur të dijë se çka ka parë.
- 1676 - Fjodor Aleksejeviç bëhet Car i Rusisë
- 1788 - Dita e Australisë
- 1861 - Kanzasi bëhet shteti i 34 i SHBA.
- 1916 - Bombardimi i parë i Parisit nga Cepelinët gjerman.
- 1922 - Shpërbëhet Bashkimi i Kosta Rikës, Guatemalës, Hondurasit dhe El Salvadorit.
- 1942 - Peru dhe Ekuadori nënshkruajnë Protokollin e Rios për përcaktimin e kufijve.
- 1991 - Nelson Mandela dhe Mangosuthu Buthelezi takohen pas 28 viteve.
- 2001 - Mijëra studentë protestojnë duke sulmuar parlamentin dhe njëkohësisht kërkojnë dorëheqje nga kryetari Abdurrahman Wahid për shkak të kinse përfshirjes në skandal me korrupsion.



Sytë e qenve arrijnë të shikojnë dhe në errësirë, kjo pasi sytë përmbajnë një cipë të veçantë të quajtur "lucidum tapetum", e cila u lejon atyre të shohin në errësirë.



A E DINI SE...

Individët me sindromën Down kanë 47 kromozome në vend të 46 kromozomeve që kanë individët pa këtë sindromë. Si ndodh kjo? Ata kanë një kopje shtesë të kromozomit të 21.



SHBA-ja është prodhuesja më e madhe e djathit në botë. Australia dhe Zelanda e Re kryesonin më parë por ranë për shkak të rritjes së kostove dhe ndryshimit të klimës.



BARSOLETA

**MOTRA, VËLLAI DHE E DASHURA**  
Një gocë e vogël 5 vjeçe, të dashurës së vëllait që vjen çdo ditë në shtëpinë e tyre, i thotë:  
Ti vjen këtu dhe takon ditë për ditë vëllain tim...  
S'ke vëlla tëndin ti moj!!



Suksesi është një mësues i mbushur me vese. Josh njerëzit e zgjuar të mendojmë se ata nuk humbin kurrë. **(BILL GATES)**



THËNIA E DITËS